



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

*nr prot 1353*

*dt 31/12/2017*

MIRATOHET:



# Strategjia e Zhvillimit KLSH 2018 - 2022

Miratuar

me Vendim të Kryetarit të KLSH  
nr. 229, datë 31.12.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr. 1352 Prot.

Tiranë, më 31/12/2017

**VENDIM**

Nr. 228, Datë 31/12/2017

**PËR**

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË**  
**BURIMEVE NJERËZORE TE KLSH-SË.**

Bazuar në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;  
Në kuadrin e objektivave të zhvillimit institucional në drejtim të menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore;  
Në zbatim të Planit të implementimit të rekomandimeve të rezultuara nga zbatimi i projektit IPA 2013, miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 83 datë 30.06.2017 “Për zbatimin nga strukturat e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Rekomandimeve të adresuara nga misionet e zhvilluara në kuadër të implementimit të projektit të binjakëzimit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave Burimeve Njerëzore në Kontrollin e Lartë të Shtetit.
2. Ngarkohet Drejtorja e Metodologjisë dhe Zhvillimit e Sektori i Trajnimit për përfshirjen në Planin Vjetor të Trajnimeve të këtij dokumenti në funksion të njohjes së stafit të KLSH-së me politikat e menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ngarkohet për zbatimin e Dokumentit të Politikave Burimeve Njerëzore, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe të gjithë punonjësit e KLSH-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

Bujar  **LESKAJ**

|  |    |
|--|----|
| <b>PËRMBAJTJA</b> .....  |    |
| <b>Mesazhi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit</b> .....   | 3  |
| <b>I. ZHVILLIME DHE ANALIZA NË DINAMIKËN HISTORIKE</b> .....   | 5  |
| I.1. Auditimi i jashtëm publik në Shqipëri në vitet 1925-1990 .....  | 5  |
| I.2. Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën e tranzicionit në Shqipëri dhe Reforma institucionale.....   | 5  |
| <i>Reforma institucionale</i> .....  |    |
| I.3. Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2013-2017 .....   | 7  |
| <b>II. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET</b> .....  | 19 |
| <b>III. ANALIZA SWOT</b> .....   | 22 |
| <b>IV. PARTNERËT KRYESORË STRATEGJIKË</b> .....  | 26 |
| IV.1 Qytetari Shqiptar.....  | 26 |
| IV.2 Presidenti i Republikës së Shqipërisë .....   | 27 |
| IV.3 Kuvendi i Shqipërisë.....   | 27 |
| IV.4 Shoqëria civile, Mediat dhe Shoqatat profesionale të fushës .....   | 28 |
| IV.5 SAI-t homologe dhe Organizatat Ndërkombëtare të Auditimit - Binjakëzimi me NIK-un e Polonisë.....   | 29 |
| IV.6 Zyra e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së dhe Gjykata Evropiane e Audituesve.....   | 30 |
| IV.7 Delegacioni i BE-së në Shqipëri , Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Komisioni Evropian, Programi SIGMA dhe Agjencinë e Zhvillimit Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara, USAID..... | 31 |
| <b>V. FOKUSI STRATEGJIK I KLSH - QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2018 – 2022</b> .....   | 32 |
| <b>QËLLIMI 1: RRRITJA E IMPAKTIT TË PUNËS AUDITUESE ME FOKUS NË 6E-TË</b> .....  | 33 |
| <b>1.1. FORCIMI I PAVARËSISË DHE MANDATIT TË KLSH</b> .....  | 33 |
| <b>1.2. AUDITIMI MBI BAZË RISKU – qasje efektive e auditimit</b> .....   | 34 |
| <b>1.3. KRYERJA E AUDITIMIT FINANCIAR NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT</b> .....  | 34 |
| <b>1.4. FOKUSI NË RRRITJE DREJT AUDITIMIT TE PERFORMANCËS</b> .....  | 37 |
| <b>1.5. THELLIMI NË AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT</b> .....  | 38 |
| <b>1.6. KONSOLIDIMI I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË VLERËSUAR SIPAS KËRKESAT E ISSAI-VE</b> .....   | 39 |
| <b>1.7. CILËSIA SI PRIORITET I KLSH - PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE PËRFITIMI NGA AUDITIMET E KLSH</b> ..40   |    |
| <b>1.8. FORCIMI I NDJEKJES SË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE, RRRITJA E NIVELIT TË REKOMANDIMEVE TË PRANUARA DHE TË ZBATUARA.</b> .....   | 41 |
| <b>1.9. RRRITJA E IMPAKTIT TË RAPORTIMEVE NËPËRMJET RRRITJES SË PËRDORUESVE TË PRODUKTEVE TË KLSH-SË</b> .....   | 41 |
| <b>1.10. ROLI I KLSH-SË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT</b> .....  | 42 |
| <b>QËLLIMI 2. OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE, AFTËSIVE AUDITUESE, PROCEDURAVE TË PUNËS, LOGJISTIKËS DHE FUNKSIONEVE TË TJERA MBËSHTETËSE</b> .....                                   | 43 |
| <b>2.1. KORNIZA MATJES PERFORMANCËS - SI MJET VLERËSIMI DHE FAKTOR ZHVILLIMI TË VEPRIMTARISË SË KLSH-SË</b> .....  | 44 |

|   |           |
|---|-----------|
| <b>2.2. ZBATIMI I STANDARDEVE PROFESIONALE NËPËRMJET ZHVILLIMIT TË METODOLOGJIVE DHE STANDARDEVE TË APLIKUESHME NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKAT MË TË MIRA TË PROFESIONIT .....</b> | <b>44</b> |
| <b>2.3 Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet kultivimit të kulturës të të mësuarit gjatë gjithë jetës.....</b>                         | <b>46</b> |
| <b>2.4. Forcimi i sistemit të strukturuar të edukimit profesional nëpërmjet certifikimit të audituesve publikë dhe zhvillimit të vazhdueshëm.....</b>                         | <b>46</b> |
| <b>2.5. Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i dokumentit të politikave të burimeve njerëzore të KLSH-së.....</b>  | <b>47</b> |
| <b>2.6. Integriteti si vlerë themelore .....</b>  | <b>48</b> |
| <b>2.8. Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm .....</b>   | <b>48</b> |
| <b>QËLLIMI 3. Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit .....</b>   | <b>49</b> |
| <b>3.1 Konsolidimi i marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin .....</b>  | <b>50</b> |
| <b>3.2. Roli i KLSH në axhendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm .....</b>  | <b>51</b> |
| <b>3.3. Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i strategjisë për komunikim të KLSH-së .....</b>  | <b>51</b> |
| <b>3.4. Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet e tjera .....</b>  | <b>52</b> |
| <b>OPTIMIZIMI SI GARANCI PËR ZHVILLIMIN STRATEGJIK TË KLSH-SË.....</b>  | <b>56</b> |
| <b>VII. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SDP 2018 -2022 .....</b>   | <b>57</b> |
| <b>ANEKSI 1: METODOLOGJIA .....</b>   | <b>59</b> |

## Mesazhi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit



Strategjia e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit të auditimit suprem publik, në përmbushje të misionit të tij kushtetues. Filozofia e këtij institucioni si mbikëqyrës i fondeve publike, me një profil të konsoliduar si “watchdog” dhe “sy vëzhgues” i qytetarit, synon të kërkojë vlerën e parasë së shpenzuar të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të tyre me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, për një shërbim sa më të mirë dhe të përgjegjshëm ndaj qytetarit dhe taksapaguesit shqiptar.

Duke plotësuar misionin e tij kushtetues e ligjor, Kontrolli Lartë i Shtetit garanton qytetarin, publikun dhe Kuvendin për nivelin e përgjegjshmërisë me të cilin Qeveria Shqiptare dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore menaxhojnë paratë publike, mirëmbajnë asetet e tyre, si dhe siguron llogaridhënien dhe transparencën e këtyre fondeve.

KLSH është zhvilluar në këto vite të transformimit të Shqipërisë, nëpërmjet hartimit dhe implementimit të strategjive duke filluar që nga dokumenti i parë strategjik për periudhën 2008-2012, i plotësuar në vitin 2012, dhe më pas i ndjekur nga Plani Strategjik 2013-2017, që përbën strategjinë e parë të ndryshimit dhe reformës së thellë institucionale në KLSH.

Rrugëtimi i nisur për rritjen në shumë dimensione na mundëson që të paraqesim Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022, mbështetur në Kushtetutën e Shqipërisë, në përcaktimet e Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në kuadrin nënligjor si dhe zhvillimet e praktikave më të mira të institucioneve partnere homologe, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit publik.

Mendimi Strategjik mbështetet në motot tona : “*Të bashkuar në ambicie e vendosmëri*” dhe “*Auditimi në shërbim të qytetarit*” të Kongresit INCOSAI XXII-të të INTOSAI-t, në Dhjetor 2016 në Abu Dhabi, dhe “*Si mund të ndihmojnë SAI-et në rikthimin e besimit të qytetarëve tek qeverisja publike*”, e Kongresit të X-të të EUROSAT-t, të zhvilluar në maj 2017 në Stamboll, Turqi.

Strategjia i përgjigjet kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të INTOSAI-t (ISSAI-ve) dhe është mbështetur në udhëzuesit metodologjikë të publikuar për këtë qëllim nga organizatat ndërkombëtare profesionale dhe Nisma për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI). Planet Strategjike të INTOSAI-t 2017-2022 dhe EUROSAT-t 2018-2023, të miratuara në Kongreset përkatëse cituar më sipër, kanë shërbyer si udhërrëfyes në hartimin e kësaj Strategjie të institucionit për pesë vitet e ardhshme.

Nëpërmjet Vizionit, në përmbushje të Misionit të tij në këtë Strategji, KLSH synon t’u përgjigjet sfidave dhe kërkesave të kohës, duke u aftësuar t’u qëndrojë dhe përshtatet ndryshimeve në mjedisin rrethues, me të cilat ballafaqohet sektori publik. Njëkohësisht, ai investon në ekspertizën e nevojshme dhe të domosdoshme në fusha të tilla si zhvillimet dixhitale, qëndrueshmëria e financave publike, efektiviteti dhe efikasiteti e menaxhimit të programeve qeveritare, kryesisht në atë të partneritetit publik-privat, etj.

KLSH aspiron që nëpërmjet auditimeve të tij të sjellë vlerë të shtuar në shërbimin ndaj qytetarit, Kuvendit dhe subjekteve publike që auditon. Kjo nënkupton sigurimin e aftësive

më të mira profesionale dhe njohurive mbi standardet ndërkombëtare të fushës për të gjithë trupën audituese dhe personelin ndihmues në KLSH, nëpërmjet punës së përbashkët, duke zbatuar një nga parimet e ISAI 12, që të udhëheqë nëpërmjet shembullit.

Gjithashtu, filozofia e hartimit të këtij dokumenti strategjik është mbështetur në rekomandimet e dhëna nga raportet dhe vlerësimet e organizatave ndërkombëtare, si: DG-Budget nëpërmjet Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë; vlerësimet e SIGMA-s, nëpërmjet raporteve të monitorimit; Raporti i rishikimit mes kolegëve “Peer Review”, i realizuar nga ekspertët e Gjykatës Austriake të Auditimit në vitin 2016; raportet e misioneve të ekspertëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë (NIK) dhe të Zyrës së Auditimit Shtetëror të Kroacisë në kuadrin e Projektit të Binjakëzimit me Fonde IPA 2013 “Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm Publik në Shqipëri”; si dhe rekomandimet nga ekspertët e SAI-ve të përparuar të Evropës, GAO-s (Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-ve) dhe ECA-s (Gjykatës Evropiane të Audituesve), të cilat janë përkthyer dhe po implementohen nga institucioni si detyra dhe objektiva parësorë për zhvillimin strategjik të tij në të tashmen dhe të ardhmen.

Strategjia 2018-2022 e KLSH-së, duke u bazuar në arritjet e Planit të mëparshëm Strategjik 2013-2017, përvijon të menduarit strategjik dhe profesional, duke përcaktuar objektiva dhe plan pune, pas kryerjes së analizave të thelluara mbi eksperiencat dhe parashikimet, duke vepruar ndaj ndryshimeve të mjedisit dinamik ku vepron institucioni, për menaxhimin sa më të sukseseshëm të sfidave dhe risqeve. Ky proces realizohet duke ruajtur vlerat dhe parimet e një institucioni suprem auditimi, të sanksionuara në Deklaratën e Limës, *Magna Carta* e SAI-ve, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ky dokument është hartuar dhe mbartë komentet e ekspertëve të Programit SIGMA, të cilët në mënyrë të vazhdueshme kanë kontribuar për modernizimin e KLSH-së

Performanca e zbatimit të Strategjisë do të matet kundrejt qëllimeve të qarta, objektivave dhe aktiviteteve të detajuara, si dhe treguesve të mirëpërcaktuar, duke synuar impaktin maksimal të plotësimit të rekomandimeve dhe këshillimit për subjektet e audituara, në shërbim të llogaridhënies dhe informimit ndaj qytetarit dhe Kuvendit për përdorimin e fondeve publike me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

**Dr. Bujar LESKAJ**

**KRYETAR I KLSH**

**Dhjetor 2017**



## I. ZHVILLIME DHE ANALIZA NË DINAMIKËN HISTORIKE

Nga krijimi në vitin 1925, përgjatë 92 viteve të ekzistencës së tij, Institucioni Kushtetues i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka evoluar në formë dhe përmbajtje, duke reflektuar historinë dhe ecurinë e Shtetit Shqiptar. Zhvillimi i KLSH-së ka ndjekur tre periudha të ndara qartë, në këndvështrimin e veprimtarisë së tij.

---

### I.1. Auditimi i jashtëm publik në Shqipëri në vitet 1925-1990

Pas miratimit të Statutit Themeltar të Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, Ahmet Zogu më datë 20 maj 1925 firmosi Dekret - Ligjin “Mbi formimin e Këshillit Kontrollues”, i cili hyri në fuqi më 26 maj 1925, data kur u votua në Parlament. Kjo datë konsiderohet si dita e krijimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në atë kohë me emrin Këshilli Kontrollues. Këshilli Kontrollues u krijua si organ kushtetues dhe nuk varej nga asnjë ministri. Në vitet 1928-1939, vendi u drejtua nga një monarki institucionale. Me ligj të veçantë u përcaktua forma e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së institucionit, i cili u quajt Kontrolli Shtetëror, si dhe mënyra e raportimit në Parlament dhe marrëdhëniet e tij me Qeverinë dhe Mbretin.

KLSH kujton me nderim figura dhe personalitete që e kanë drejtuar këtë institucion, gjatë kësaj periudhe, të cilët kontribuan duke marrë përvojat më të mira të kohës në shtetet e zhvilluara përreth nesh, në lidhje me kontrollin dhe inspektimin financiar z. Fejzi Alizoti, z. Kol Thaçi, z. Lac Gera, z. Llambi Aleksi, z. Lame Kareco, z. Eqerem Libohova, z. Xhafer Ypi, z. Rrok Gera, z. Izedin Beshiri dhe të tjerë.

Në muajin gusht të vitit 1946 u krye riorganizimi tërësor i organeve të kontrollit, si në formë edhe në përmbajtje. Me ligj të veçantë të Kuvendit Popullor u krijua Komisioni i Kontrollit të Shtetit, i cili ishte në përbërje të Qeverisë dhe në varësi të plotë prej saj (strukturë nën varësinë e ekzekutivit dhe të partisë-shtet), duke humbur pavarësinë dhe duke qenë në shërbim të politikës së shtetit totalitar. Në vitin 1982, me rënien ekonomike të vendit, Qeveria e partisë-shtet suprimoi strukturën e mëparshme dhe themeloi Inspektimin e Shtetit. Ndërsa, në vitin 1987, Kuvendi Popullor rikthen strukturën e Komisionit të Kontrollit të Shtetit me atributet e një ministrie, duke mbetur i tillë si pjesë e ekzekutivit deri në vendosjen e sistemit demokratik në vend.

Komisioni i Kontrollit të Shtetit ka qenë anëtar formal i INTOSAI-it që nga viti 1984, dhe anëtar aktiv nga viti 1992<sup>1</sup>.

---

### I.2. KLSH në periudhën e tranzicionit në Shqipëri dhe Reforma institucionale

Me vendosjen e pluralizmit në Shqipëri, me asistencën e BE-së u hartua projektligji “Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit”, i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në 31 gusht 1992. Ky ligj sanksionoi se Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ishte organi më i lartë i kontrollit ekonomik-financiar dhe i pavarur nga qeveria. Pavarësia e plotë, depolitizimi dhe departizimi i organit suprem të kontrollit u realizuan me miratimin e Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” si dhe më pas u sanksionuan në ligjin themelor

---

<sup>1</sup> Burimi: “Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit 1925-2012”, Botimet KLSH 09/2012, fq.98-99

të Shtetit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, pjesa e katërmbëdhjetë “Kontrolli i Lartë i Shtetit”, nenet 162-165. KLSH gjatë kësaj periudhe ka vepruar në mënyrë të pavarur, duke fuqizuar identitetin e tij dhe duke bashkëpunuar me institucionet homologe dhe partnerët ndërkombëtarë. Në vitin 1993, KLSH u bë pjesë e një prej 50 anëtareve të EUROSAI- Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Në datën 27 nëntor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri të KLSH-së, nr.154/2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH”, i cili hyri në fuqi në shkurt 2015. Ky akt vulosi ligjërisht kthesën përfundimtare të institucionit nga një strukturë me veprimtari kryesisht të inspektimit financiar gjatë periudhës 1992-2011, në një institucion që gëzon një shkallë të lartë të pavarësisë, si parimin themelor të institucionit suprem të auditimit.

KLSH kryhen jo vetëm auditime përputhshmërie dhe financiare, por edhe auditime të performancës dhe të teknologjisë së informacionit. Një risi tjetër e ligjit është përcaktimi i kompetencës së Kontrollit të Lartë të Shtetit për të audituar edhe përdoruesit e fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian ose organizata të tjera ndërkombëtare. Ligji i ri, po ashtu, ka dispozita të qarta që garanton pavarësinë funksionale dhe organizative të institucionit. Ai ezauron të gjithë problematikën që KLSH ka patur në lidhje me aksesin në informacion dhe dokumentacion tek subjektet e audituara.

**Ky ligj realizoi profilizimin e KLSH-së si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon aktivitetin e tij tërësisht në standardet ndërkombëtare ISSAI të INTOSAI-t.**

KLSH i mandatar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe udhëhequr nga standardet e praktikave ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t, të konstituara në Ligjin 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, synon në mënyrë të vazhdueshme perfeksionimin, duke ristrukturuar mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të tij, duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin, për të përmirësuar qasjet audituese dhe për të shfrytëzuar më mirë perspektivën ndër-qeveritare.

*“Qytetarët janë përfituesit kryesorë të auditimit publik. Është detyrë e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) të performojnë me auditime cilësore dhe t’u ofrojnë qytetarëve raporte që mbështesin transparencën, llogaridhënien dhe besimin në qeverisje. Vetëm puna e mirë dhe profesionale audituese mund të bëjë ndryshimin e vërtetë në jetët e tyre”<sup>2</sup>*

KLSH në përmbushje të orientimeve të Kongresit të XXII të Abu d’Habit, si një trupë profesionale e pavarur, ka fokusuar veprimtarinë e saj institucionale drejt një zhvillimi të qëndrueshëm në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, GAO-s dhe me rekomandimet e Progres Raporteve të BE-së.

KLSH me mbështetjen e ekspertëve të BE-së dhe SIGMA-s hartoi Strategjinë e saj të parë për periudhën 2008 -2012. Efektet e reformimit institucional kërkuan rishikimin e këtij Plani të Zhvillimit, në vitin 2012, duke pasqyruar jo vetëm ndryshimet e ndodhura, por dhe

<sup>2</sup>Pjesë nga deklarata e Kongresit të XXII të INTOSAI-t, Dhjetor 2016 në Abu Dhabi, “40 vjet Deklarata e Limës(1977 – 2017)”, Seria Botime KLSH- 16 2017/83



vizionin e ri strategjik të institucionit për periudhën e ardhme dhe që shtruan bazat për Planin e ri Strategjik të Zhvillimit 2013 -2022.

Periudha 2012-2017 konkretizoi filozofinë inovative të platformës së reformës institucionale të paraqitur nga Dr.Bujar Leskaj, kandidat i nominuar si Kryetar i KLSH në Dhjetor 2011, para Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë, në të cilën theksohej se: “... KLSH do ta formatojë punën, duke e organizuar atë sipas parimeve të deklaratave INTOSAI të Meksikos (2007) dhe të Johaneshburgut (2010), sipas praktikave më të mira të institucioneve simotra në vendet më të përparuara të Bashkimit Europian dhe e mbështetur tërësisht në kornizën e plotë kushtetuese dhe ligjore të vendit.”<sup>3</sup>

Plani Strategjik i KLSH, 2013-2017, u përgatit me ndihmën e ekspertëve të Programit SIGMA/OECD. I mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, implementimi i Planit Strategjik 2013 -2017 e orientoi KLSH-n drejt zhvillimeve që do ta vendosnin këtë institucion në krah të institucioneve homologe të rajonit. Për më tepër, Strategjia për periudhën e ardhme synonte që ta vendosë KLSH shumë pranë SAI-ve të zhvilluara të vendeve anëtare të BE-së.

### 1.3 Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2013-2017

Strategjia e Zhvillimit të KLSH për periudhën 2013-2017 përcaktoi 6 Qëllime Strategjike të cilat mbuluan dimensionet më të rëndësishme të rritjes të institucionit, mbështetur në një analizë të thellë dhe profesionale të statusit të institucionit për vlerësimin e nevojave por mbi të gjitha me një fokus të qartë për çfarë ky Institucion kërkohej të arrinte në horizontin e pesë viteve më pas.

Objektivat Strategjikë të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t u integruan në koherencë të plotë në Planin Strategjik duke u formalizuar në objektivat kryesore si: zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH, rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës, zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim, rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit, si dhe rritja e ndikimit të rolit të KLSH-së përmes komunikimit dhe bashkëpunimit.

KLSH fokusoi përpjekjet për zhvillim institucional duke vendosur si qëllim të parë strategjik forcimin e pavarësisë dhe zbatimin e parimeve themelore të auditimit të Deklaratës së Limës dhe Deklaratës së Meksiko-s nëpërmjet amendimit të bazës rregullatore të KLSH-së në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Veprimtaria e institucionit në lidhje me këtë objektiv është vlerësuar nga Gjykatës së Auditimit të Austrisë, nëpërmjet procesit të “Peer Review (Rishikim mes kolegëve)”. Këto gjetje u prezantuan nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, në Konferencën e organizuar me rastin e 40- vjetorit të Deklaratës së Limës mbi Pavarësinë e SAI-ve, në LIMA, Peru më 5 Dhjetor 2017, duke konfirmuar opinionin e vlerësimit se.... *pavarësia, mandati dhe organizimi i ALSAI janë ligjërisht de facto të vendosura dhe të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga Ligji i ALSAI-t. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ALSAI-t në vitin 2015, ALSAI pati përmirësime të rëndësishme në pavarësinë e tij krahasuar me parashikimet e ligjit të mëparshëm. .... korniza ligjore e vendosur është e përshtatshme dhe efektive dhe qëndron në pajtueshmëri me Deklaratën e Meksikos”*<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Projekt-ide paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë nga Dr. Bujar Leskaj, 14 Dhjetor 2011. “ KLSH Analiza Vjetore 2011”, Seria: Botime KLSH: 01/2012, fq.6

<sup>4</sup> Raporti Final i “Rishikimit nga Kolegët” mbi Pavarësinë e ALSAI-t, ACA. Gjykata Austriake e Auditimit, Qershor 2017, Revista “Auditimi Publik” Nr. 16/2017, Seria: Botime KLSH- 06/2017/73, fq. 66 parag. 1.3.

Zhvillimi i qasjes audituese, por edhe i proceseve të vlerësimit metodologjik përbëjnë bazat për funksionimin në nivelet e kërkuara institucionale. Kontrolli i Lartë i Shtetit është në fazën e konsolidimit të procedurave të funksionimit dhe të metodologjisë audituese dhe këto zhvillime kanë mbuluar përmbushjen e tre objektivave kryesore:

zbatimin e kornizës legislative dhe standartet të ISSAI-ve për auditim,  
zhvillimin e mëtejshëm të metodologjisë të auditimit dhe të kapaciteteve audituese.  
forcimin e kapaciteteve institucionale, si dhe përmirësimin e impakteve të auditimit.

Instrumentat kryesorë të proceseve zhvillimore u bënë strategjitë kyç të hartuara dhe implementuara gjatë periudhës :

*Strategjia Zhvillimit të KLSH, 2013-2017, e rishikuar.*

*Strategjia e Menaxhimit të Riskut*

*Strategjia e Implementimit të Standardeve të Auditimit ISSAI.*

*Strategjia e Kominikimit të KLSH, 2017 -2019*

Monitorimi sistematik i përvitshëm dhe rishikimi i kryer në çdo dy vjet i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017, i kanë shërbyer KLSH për të matur dhe vlerësuar progresin e bërë kundrejt veprimtarive të planifikuara dhe për të marrë siguri se po ecet drejt arritjes së objektivave strategjikë.

Ligji i ri, nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ofroi bazat që institucioni të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si dhe praktikave më të mira të profesionit mbarëbotërore. Aktet nënligjore në zbatim të Ligjit, kuadri i brendshëm rregullator administrativ e organizativ së bashku me Manualet dhe udhëzuesit specifikë në funksion të adoptimit të Standardeve ISSAI kanë krijuar tashmë për KLSH-ën një infrastrukturë të konsoliduar legislative dhe procedurale mbi të cilin do të vazhdojë të mbështetet veprimtaria audituese e institucionit.

Prej fillimit të vitit 2012, janë hartuar e miratuar akte nënligjore, rregullat e brendshme të organizimit, manuale e udhëzues procedural për auditimin, mbi bazën e të cilave është organizuar dhe vijon të kryhet veprimtaria institucionale në përgjithësi. Kështu, në shërbim të drejtpërdrejtë të kryerjes së auditimeve janë përgatitur Manualet përkatëse për çdo lloj auditimi: Manuali Auditimit të Përfomancës, i mbështetur nga Indikatorët e Përfomancës; Manuali Auditimit të IT, mbështetur nga Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit, COBIT 4.1; Manuali Auditimit Financiar; si dhe, Manuali Auditimit të Përputhshmërisë. Hartimi dhe miratimi i Manualeve të Auditimit sipas llojeve u realizua duke harmonizuar gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e procedurave të auditimit në përputhje me ISSAI-t specifik përkatës.

KLSH, për përmbushjen e objektivit strategjik, për zhvillimin e standardeve kombëtare të auditimit, gjatë viteve 2012-2017 ka përkthyer dhe publikuar ISSAI-të e përditësuara si një bazë e rëndësishme për zhvillimin e standardeve nga vete institucioni i KLSH-së dhe konkretisht: *ISSAI 100* “Parimet themelore të Auditimit në Sektorin Publik”; *ISSAI 200* “Parimet themelore të Auditimit Financiar”; *ISSAI 300* “Parimet themelore të Auditimit të Përfomancës”; *ISSAI 400* “Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë”.

Gjithashtu, Paketa e INTOSAINT të Auditimit të Integritetit, lançuar në vitin 2012 nga Gjykata e Auditimit e Hollandës, është botuar dhe aplikuar me sukses që prej vitit 2014, rezultatet e të cilit kanë qenë pjesë e Analizës e Vjetore të Përfomancës Institucionale. Ky proces është vijuar edhe në vitet në vazhdim.


Udhëzues dhe urdhra specifike që mbulojnë çështje më teknike janë përgatitur dhe zbatuar në vazhdimësi, duke mbështetur aktivitetin e gjithë trupës audituese, ku përfshihen: *treguesit e matjes së performancës institucionale; udhëzime për procedurat për ndjekjen dhe*

*dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, udhëzime mbi rritjen e kapaciteteve audituese dhe të cilësisë në auditim, metodologjia e planifikimit vjetor në auditim, dokumenti politikave të burimeve njerëzore, rishikimi dhe përditësimi i manualit të performancës, zhvillimi i manualit interaktiv të auditimit të IT dhe moduleve standard të trajnimit për auditimin IT, zhvillimi i metodologjisë për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë etj.*

Filozofia e KLSH-së në përmbushje të **objektivit të dytë strategjik**, rritja e kapaciteteve audituese dhe të cilësisë së auditimit, është udhëhequr nga parimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke e bazuar zhvillimin metodologjik dhe profesional i burimeve njerëzore në dy shtylla kryesore: krijimin e një profili të lartë profesional të audituesit të jashtëm publik; dhe, sigurimin e kryerjes së veprimtarisë audituese në përputhje të plotë me standardet e auditimit të jashtëm publik si dhe praktikat e mira të fushës të konkretizuara në manualet e auditimit, rregullore të procedurave të auditimit, përmirësimin e raportimit dhe transparencës si dhe trajnimi e vazhdueshëm të stafit auditues.

Kongresi i XXII I INTOSAI në Abu D’Habi inkurajoi SAI-t të përdorin *Kuadrin e Kompetencave Profesionale, për të formuar trupën e sotme dhe të ardhshme të audituesve më të lartë të sektorit publik.*

Qasja pro- aktive e KLSH për t’i bërë këto pjesë të praktikave reale tregohet në progresin e bërë në zhvillimin e kapaciteteve ku struktura e trupës audituese ka evoluar në madhësi e përmbajtje, sikurse prezantohet në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku1: *Struktura e trupës audituese sipas profesioneve.*

Krahas treguesve të përbërjes profesionale të burimeve njerëzore, gjatë periudhës 6 vjeçare ka patur ndryshime pozitive dhe në treguesin e moshës mesatare të punonjësve të institucionit, e cila në fund të vitit 2017 është ulur deri në 42 vjeç, kundrejt nivelit mesatar 50 vjeç në vitin 2011.



Grafiku 2: Mosha mesatare e audituesve në vite



Grafiku 3: Ndryshimi i Raportit Femra Vs. Meshkuj në përbërje të trupës audituese në vite

Ndryshimi i raportit femra-meshkuj, sipas të cilit auditueset femra përbejnë aktualisht 40% nga 33.5 % të numrit të audituesve që ishin në vitin 2011, konfirmon qasjen e kujdesshme ndaj barazisë gjinore në institucion. Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gruas, reflektohet në numrin e koniderueshëm që drejtueset femra zënë në nivele menaxheriale, duke përfaqësuar 10 pozicione drejtuese kundrejt 21 drejtues në total për gjithë institucionin si: Sekretare e Përgjithshme, Drejtore të Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie dhe Kryeaudituese.

**Struktura organizative dhe organizimi** e KLSH-së janë konsideruar si një element jo statik, por në zhvillim dinamik e në përgjigje të ndryshimeve të shpejta që kërkon ambienti. Vëmendje iu është kushtuar zgjidhjeve të përshtatshme si në nivel taktik ashtu dhe strategjik.

Ndërtimi i strukturës dhe organizimi i institucionit ka synuar një menaxhim efektiv institucional, një strukturë të qartë dhe me shtresëzim sa më optimal, me përgjegjësi dhe detyra të mirëpëcaktuara, si për funksionet primare audituese ashtu dhe ato mbështetëse duke synuar një hierarki të përshtatshme dhe linja të qarta raportimi. Gjithashtu, janë reflektuar kërkesat e “*COSO model*” kundrejt pesë komponentëve për të siguruar sisteme efektive të kontrollit të brendshëm duke formuar në këtë mënyrë një sistem të integruar që reagon në mënyrë dinamike ndaj ndryshimit të kushteve.

Një kthesë e rëndësishme drejt modernizimit të institucionit u shënua me krijimin e *Departamentit të Auditimit të Performancës*, në Tetor të vitit 2012, i cili i parapriu qasjeve të reja të auditimit. Krijimi në vitin 2015 i *Departamentit të Politikave të Auditimit* si udhëheqje metodologjike dhe zhvillim profesional, siguroi njëkohësisht lidhjen e tre elementëve bazë të zhvillimit profesional: kërkimin-metodologjinë-trajnimin. Në vitin 2017 ky Departament u riorganizua, duke u ngritur në një nivel më të lartë forme organizimi, si *Departamenti i Metodologjisë dhe Strategjisë së Auditimit*, duke iu përshtatur më mirë kërkesave në rritje për një institucion modern auditimi sikurse synon të shndërrohet KLSH.

Në funksion të objektivit të KLSH-së, për të bërë pjesë të veprimtarisë së saj audituese edhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit, në vitin 2014 u krijua *Drejtoria e Auditimit të TI-së*, e cila hodhi bazat e kryerjes së auditimeve të sistemeve të teknologjisë së infomacionit, si veprimtari audituese e domosdoshme në kushtet e epokës së sistemeve të dixhitalizuara.

Gjithashtu, janë përmirësuar strukturat brenda departamenteve ekzistuese si: Departamenti Juridik dhe i Zbatimit të Standardeve, brenda të cilit funksionon *Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve*; dhe, në përmbushje të kërkesave të ISSAI 40 “Sigurimi i cilësisë” është krijuar Sektori i Kontrollit të Cilësisë .

Gjatë periudhës 2012 – 2017, trupa audituese e KLSH-së është zhvilluar mbi të gjitha në drejtim të krijimit të një profili të lartë profesional, me auditues që zotërojnë dije, aftësi dhe integritet. Me qëllim përmirësimit e performancës si dhe për të fituar njohuri e teknika të reja, një pjesë e audituesve kanë përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo zotërojnë çertifikata profesionale të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar, përkatësisht : 2 Drejtues të nivelit të lartë kanë titullin “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”; 6 drejtues/auditues kanë titullin “Doktor i Shkencave”; 18 (10 %) auditues kanë diplomë të dytë nga të cilët 15 në Drejtësi, 4 në Financë dhe 1 të tjera. Gjithashtu, 2 auditues kanë Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA); 5 auditues kanë çertifikatën Kontabël i Miratuar dhe 2 auditues kanë çertifikatën Ekspert Kontabël; 22 auditues kanë çertifikatën e Audituesit të Brendshëm; 11 auditues kanë çertifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme. Po kështu 9 auditues kanë çertifikata të trajnimeve të zhvilluara on-line nga IDI<sup>5</sup> etj.

Në zbatim të politikave të zhvillimit profesional, bazuar në marrëveshje dhe marrëdhënie me institucionet ndërkombëtare të auditimit, gjatë periudhës 2013-2017, është përfituar nga programe *internship* për periudha 5-6 muaj në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), Luksenburg, përkatësisht 12 auditues, dhe 5 auditues në Zyrën e Auditimit të Qeverisë Amerikane (GAO), eksperiencia që vazhdojnë të aplikohen me sukses.

Procesi i trajnimit të vazhdueshëm funksionon në mënyrë efektive prej vitit 2012, duke u përmirësuar në vijimësi, tashmë ka marrë formën e një sistemi të konsoliduar dhe reflekton mesazhin e Kongresit të XXII të INTOSAI-t, Dhjetor 2016, në Abu Dhabi, ku 192 SAI-t anëtare ranë dakord “.. për të përcaktuar profesionalizimin si një proces të vazhdueshëm, me të cilin audituesit dhe organizatat e tyre SAI-t sigurojnë nivele të larta të ekspertizës, kompetencës, sjelljes etike dhe të cilësisë, mbështetur në standardet profesionale (ISSAI).”

Si rrjedhojë e ndjekjes së një politike të qartë dhe të mirëpërcaktuar në lidhje me zhvillimin profesional të kapaciteteve njerëzore, që KLSH ka zbatuar gjatë 5 viteve të fundit, është rritur në mënyrë të ndjeshme treguesi i ditëve të trajnimit për çdo auditues të kryera në vit. Kështu, për gjashtë vitet e fundit (2012-2017) janë realizuar mesatarisht 25 ditë trajnimi për auditues, krahasuar me periudhën 10 vjeçare (2002-2011), ky tregues ka qenë vetëm 2.1 ditë trajnimi për auditues apo rreth 13 herë më pak, nga çfarë i ofrohet sot çdo audituesi të KLSH-së.

Gjatë implementimit të Strategjisë 2012-2017, në përmbushje të angazhimit për njohjen dhe zbatimin me rigorozitet të ISSAI-ve, kujdes i veçantë i është kushtuar përmbajtjes së trajnimeve. Procesi i analizës së nevojave për trajnim ka bërë të mundur që Programi i Trajnimeve të bazohet tek kërkesa dhe të orientohet nga rezultati duke përfshirë një kuadër të gjerë tematikash. Trajnimet në fushën e metodologjisë audituese përfshirë, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t,



Grafiku 4: Dinamika e treguesit “Ditë mesatare të trajnimit”


<sup>5</sup> IDI- Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t



Manualet e Auditimit (performancës, financiar, përputhshmërisë e rregullshmërisë dhe TI-së) dhe udhëzues specifikë të qasjes dhe teknikave të auditimit kanë zënë 39% të totalit të trajnimeve; 35% e kanë përbërë trajnime në fushën e kuadrit rregullator dhe legjislativ të përgjithshëm në nivel kombëtar dhe institucional të lidhura me veprimtarinë audituese si dhe të tjera që kanë impakt në punën e KLSH-së; si dhe, 26% trajnime në çështje specifike të auditimit nëpërmjet workshop-eve dhe vizitave studimore në SAI-t homologe, si praktika më të mira ndërkombëtare të fushës.


Në zbatim të Programit të Trajnimit, aktivitetet janë ofruar në 53% nga ekspertë brenda KLSH-së, 23% nga ekspertë të jashtëm nga partnerët strategjikë të institucionit jashtë vendit dhe 24 % e trajnimeve janë organizuar brenda vendit nga ekspertë të jashtë KLSH-së apo nëpërmjet sistemeve ‘e-learning’ në distancë.

Zhvillimi dhe modernizimi institucional është parë i lidhur ngushtë me krijimin e kapaciteteve audituese dhe më pas me zhvillimin dhe përsosjen e tyre. Si rrjedhojë e kësaj politike të ndjekur është rritur ndjeshëm numri i auditimeve në tërësi si dhe është ndryshuar struktura e tyre duke marrë përparësi qasjet e reja audituese si auditimi i performancës, i teknologjisë së informacionit dhe atij financiar. Statistikat tregojnë se janë kryer mesatarisht 157 auditime në vit gjatë periudhës 2012-2017, ndërkohë që gjithë periudhën 10-vjeçare, 2002-2011, janë kryer 151 auditime/vit. Struktura e auditimeve të realizuara gjatë zbatimit të Planit Strategjik paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 5: Struktura e auditimeve në vite për periudhën 2012 - 2017

Drejtimet e auditimit kanë synuar të realizojnë një mbulim sa më të plotë të zbatimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet subjekteve të audituara duke përdorur qasjet dhe llojet e përshtatshme të auditimit që do të siguronin njëkohësisht dhe rritjen e efektivitetit të punës audituese të KLSH- së.



Grafiku 6: Indikator i dobishmërisë së KLSH

Përfitueshmëria nga auditimet e KLSH është kthyer në një tregues domethënës i vlerës së parasë që ky institucion synon të sjellë në dobi të qytetarëve dhe vendit.

Në 6(gjashtë) vitet 2012-2017 rezulton se për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së është kërkuar për t'u zhdëmtuar 108.7 lekë, nga 21.1



lekë që është kërkuar në periudhën 10 vjeçare 2002-2011, pra 5.2 herë më shumë. KLSH synon rrisë produktivitetin dhe efiçencën e punës audituese duke përdorur gjithnjë e më shumë qasjen e bazuar në risk dhe të mbështesë punën e saj në proceset dhe teknologjitë e reja.


Dinamika e dëmit ekonomik të evidentuar nëpërmjet aktivitetit auditues nëpër vite, e paraqitur në grafikun e mëposhtëm tregon se gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë 2012-2017, vlerat mesatare të dëmit të ekonomik të zbuluar janë dukshëm më të larta se ato të periudhës 2002-2011. Ky fakt konfirmon rritjen e aftësisë audituese në zbulimin e rasteve të keq përdorimit të fondeve publike.



Grafiku 7: Indikator i dobisë së auditimit në 15 vitet, 2002 - 2017

Rritja e performancës për KLSH nënkupton, veprimtari në disa dimensione, që përfshin rritjen e auditimeve duke siguruar njëkohësisht nivel të kënaqshëm të cilësisë nëpërmjet zbatimit me korrektësi të metodave dhe qasjeve më të përparura duke i dhënë kështu KLSH-së tiparet e një institucioni modern auditimi, që ecën në krah të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve anëtare të BE-së.

Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet të ndërmarra nën **objektivin e tretë strategjik**, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Në Dhjetor 2011, Kandidati i nominuar për Kryetar i KLSH Dr. Bujar Leskaj do të cilësonte se: *...KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Përqendrimi i vëmendjes tek auditimi*



performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik..<sup>6</sup>, ide kjo e konkretizuar në një nga qëllimet strategjike të Planit të **Zhvillimit për periudhën 2013-2017**.

Nëpërmjet miratimit të Ligjit 154/2014 (Grafiku 8: Progresi i auditimeve të performancës të kryera në vite) performance në mënyrë eksplicite dhe specifike, me akses të pakutizuar, si në subjekte, ashtu edhe në informacion, sikurse dhe me të drejtën për të raportuar në Kuvend auditime individuale performance. Ky akt u pasua dhe detajua nga Manuali i Auditimit të Performancës dhe nga Seti i Indikatorëve të Matjes së Performancës, botuar nga KLSH në Prill 2015.

Gjatë periudhës 2012-2017 janë zhvilluar 58 auditime performance ose pesë herë më shumë auditime performance se gjithë periudha e mëparshme 10-vjeçare, 2002-2011. Këto auditime spikatën për llojshmërinë dhe sensibilitetin e çështjeve që mbuluan reformat ekonomike, sociale e kulturore, problematika energjetike e mjedisore, aspekte makro dhe mikro të realitetit shqiptar, duke i shërbyer në këtë mënyrë, zinxhirit të vlerës, që nga nevoja e



qytetarit, deri tek vendim-marrja e ekzekutivit e më pas tek implementimi i strukturave përkatëse.

Kërkesa në rritje nga Kuvendi i Shqipërisë për njohjen me raporte të auditimeve të performancës, si dhe impakti i tyre nga publikimi në mediane shkruar, mjediset akademike, rrjetet sociale profesionale apo përdorimi i raporteve të këtyre auditimeve nga bashkëpunëtorët e huaj vlerësohet si një tregues pozitiv i këtyre auditimeve.

Grafiku 9: Progresi i auditimeve të performancës të kryera në vite

Në 5-vjeçarin e kaluar, Departamenti i Auditimit të Performancës bashkëpunoi suksesshëm në auditime paralele dhe të pilotuara nga të huajt, angazhoi ekspertë në fushat e mjedisit, sportit, gazetarisë, energjisë, sociologjisë dhe ekonomisë, organizoi *workshop*-e e konferenca me akademikë, profesorë e kërkues të rinj shkencorë, ngriti grupe të përbashkëta pune me audituesit e departamenteve të tjera dhe inicijoi e përfundoi auditime të përbashkëta me SAI-et rajonale.

Në Strategjinë e Zhvillimit 2013 -2017, KLSH prezantoi për herë të parë **objektivin** ambicioz të **zhvillimit të auditimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit**, duke krijuar Drejtorinë e Auditimit të TI-së në Dhjetor të vitit 2014. Zhvillimet e ndodhura gjatë dekadës së fundit në ambientin ndërkombëtar të auditimit publik lidhur me teknologjinë e informacionit, gjetën konkretizim në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 të KLSH. Ky ligj përcaktoi auditimin e teknologjisë së informacionit si një lloj i veçantë i auditimi, nëpërmjet të cilit, KLSH mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente. Kërkesat e Standardeve e Praktikave Ndërkombëtare lidhur me auditimin TI-së janë reflektuar në Manualin e Auditimit TI, dhe Kornizës COBIT 4.1 “Objektivat e Kontrollit të TI”. Kjo është baza mbi të cilën auditimi i TI-së shënoi fillimet e tij si pjesë dhe lloj i veçantë i auditimit në KLSH prej vitit 2015 e në vijim.

<sup>6</sup> “ 4 Vjet Auditim i Jashtëm Publik”, Bujar Leskaj, Seria : Botime KLSH 11/2016/62, 2016 fq.21


Gjithashtu, teknikat CAAT, IDEA dhe konceptet e teknologjisë së informacionit po përdoren në procesin auditues nga të gjithë departamentet e KLSH-së. Në funksion të konsolidimit të përvojës të përfituar gjatë përdorimit të këtyre teknikave, nën moton “*experientia mutua omnibus prodest/ nga eksperiencia e përbashkët përfitojmë të gjithë*”, është zhvilluar procesi rishikimi mes kolegësh apo Peer Review, nga Drejtoria e IT të SAI të Zvicrës.

Në historinë e tij dy vjeçare, trupa e auditimit të TI-së , edhe pse modestë në numërkapacitete dhe eksperiencë përfaqësohet me auditime të TI-së në të cilat janë identifikuar rezultate domethënëse për një fushë të pa prekur më parë sikurse janë Sistemet e Teknologjisë së Informacionit. Megjithatë mbetet sfida e vazhdueshme për vetësimin i teknikave të auditimit të TI-së në një shkallë më të gjërë nga trupa audituese, për sa kohë sistemet e integruara të informacionit po përdoren në shkallë të gjerë në administratën publike.

Në përmbushje të **objektivit të pestë strategjik**, KLSH ka rritur kontributin për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit. Ndërmarrja e veprimeve kundër korrupsionit, për të përmirësuar llogaridhënien dhe transparencës, ka marrë dimensione të reja nga viti në vit. Një prej aspekteve më të rëndësishme të rolit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit është kontributi në rritjen e integritetit të institucioneve publike, të cilët në vetvete janë komponentë të sistemit kombëtar të integritetit. Në këtë kontekst në zbatim të Parimeve Themelore dhe Standardeve të INTOSAI-t, për zhvillimin e një qasje të strukturuar të hartimit dhe zbatimit të politikave institucionale të integritetit, KLSH ka aplikuar instrumentin e vetëvlerësimit të integritetit INTOSAINIT.

Në kontekstin e menaxhimit institucional, këto zhvillime u reflektuan në procesin e analizës së veprimtarisë së KLSH përgjatë vitit 2014, e cila përbënte risi jo vetëm në formë, por mbi të gjitha në përmbajtjen e saj, pasi për herë të parë analiza vjetore u krye duke përdorur një instrumentin konstruktiv dhe dobiprurës të vetëvlerësimit të integritetit INTOSAINIT. I gjithë procesi u karakterizua nga dy elementë thelbësorë për Institucionin Suprem të Auditimit: **transparenca dhe pjesëmarrja**. Nëpërmjet mekanizmit të vetëvlerësimit u siguroi gjithëpërfshirja e stafit, ku si audituesit dhe personeli mbështetës raportuan dhe dhanë idetë e tyre, nëpërmjet qasjes së këshillimit, dialogimit, mbështetjes dhe pozitivizmit. Përdorimi i instrumentit INTOSAINIT, vendos KLSH si promotor i ndërmarrjes së kësaj iniciative dhe shtrirjes së vlerësimit të integritetit në të gjitha njësitë dhe entitetet publike, duke kthyer në realitet qëllimin “*të udhëheqë nëpërmjet shembullit*”

Kontrolli i Lartë i Shtetit në përmbushje të misionit të tij, ka bërë transparente nivelin e përgjegjshmërisë së institucioneve qeveritare dhe publike. Gjatë viteve 2012-2017, masa e dëmit ekonomik të zbuluar nga institucioni i auditit të jashtëm publik shqiptar e ka kaluar



Grafiku 10: Rastet e kallëzimeve penale në vite

vlerën e 1 miliardë USD, në një ekonomi me GDP vjetore rreth 10 miliardë USD. Vetëm për vitin 2017, KLSH zbuloi një dëm ekonomik, parregullsi dhe shkelje financiare (në të ardhurat publike dhe shpenzimet e kryera) në shumën totale prej 11.5 miliard lekë ose 85.8 milionë Euro. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, i kushtuan vendit shumën totale prej 99.05 miliard lekë dëm, afërsisht 739.7 milionë euro nga e cila: 92.7 miliard lekë në fushën e të


ardhurave, afërsisht 692.1 milionë euro dhe 6.3 miliard lekë afërsisht 47.8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110.5 miliard lekë ose afërsisht 825,6 milionë euro<sup>7</sup>.

KLSH ka ndërmarrë veprime dhe ka rekomanduar masa korigjuese dhe penalizuese për çdo rast të identifikuar të mashtrimit financiar dhe korrupsionit duke synuar luftën ndaj korrupsionit si fenomen në rrënjë të sistemit dhe jo thjesht si raste individuale, sporadike. Nga ana tjetër organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere të iniciuara dhe realizuara që prej vitit 2012 e në vazhdim kanë synuar të sjellin në vëmendje të publikut të gjerë dhe ligjvënësve *se lufta kundër korrupsionit është përgjegjësi e të gjithëve dhe çdo qytetar përfiton nga kjo e fundit*.

Pjesë e pandarë e këtij kontributi, ka qenë edhe angazhimi institucional i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit, ku që nga viti 2012 deri në fund të vitit 2017, janë dërguar pranë organit të Prokurorisë, 266 kallëzime penale për 847 nëpunës dhe ish-nëpunës të administratës publike. Angazhimi i KLSH në luftën kundër korrupsionit në gjashtë vitet e fundit tregoi vazhdimësinë e vendosmërisë të shprehur në Platformën për zhvillimin e KLSH në fundvitin 2011, se *..lufta ndaj korrupsionit dhe roli parandalues i KLSH ndaj veprimeve korruptive dhe abuzive me pronën shtetërore do të jenë politika dhe veprime qendrore në Strategjinë e zhvillimit të institucionit*.<sup>8</sup> KLSH në 6 vitet e fundit, 2012-2017, ka adresuar çdo javë një Kallëzim Penal, për zyrtarët e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë, të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH, apo e shprehur ndryshe 1 kallëzim për çdo 3 auditime.

Kallëzimet penale që KLSH adreson në Prokurori, nuk janë qëllim në vetvete por shprehin angazhimin serioz institucional në luftën kundër korrupsionit dhe sidomos në luftën kundër kulturës së pandëshkueshmërisë, i cili imponon ruajtjen e një standardi të domosdoshëm ligjor dhe moral, kundrejt mostolerimit dhe mosanashkalimit, të rasteve të konstatuara të korrupsionit dhe abuzimit me detyrën.

Nën *objektivin e gjashtë strategjik*, të PSZH 2013-2017, KLSH ka integruar elementë modernë të komunikimit si dhe ka miratuar, në 2017, Strategjinë e Komunikimit 2017-2019, duke synuar të përçojë interesin dhe zërin e qytetarit dhe të publikut nëpërmjet auditimeve dhe raportimeve për gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Strategjia e komunikimit, thekson marrëdhëniet e KLSH me publikun dhe Kuvendin, si dhe duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.



- Grafiku 11: Trajtimi i letrave të popullit , 2002- 2017

<sup>7</sup> KLSH, Buletini Statistikor nr.4, Janar – Dhjetor 2017, publikuar Janar 2018.

<sup>8</sup> Projekt-Ide paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë nga Dr. Bujar Leskaj, 14 Dhjetor 2011, parag.2, faqe 7. “ 4 Vjet Auditim i Jashtëm Publik”, Bujar Leskaj, Seria : Botime KLSH 11/2016/62, 2016




Duke e vendosur veprimtarinë e tij në shërbim të qytetarit shqiptar, në fokus të politikave të komunikimit ka qenë trajtimi i ankesave dhe letrat nga qytetarët. Rëndësia që i është kushtuar këtij komponenti nga KLSH gjatë implementimit të PSZH 2013-2017, tregohet në numrin e letrave dhe ankesave të adresuara gjatë periudhës së implementimit të kësaj Strategjie, të cilat gjatë vitit 2017 arritën në 623 letra kundrejt vetëm 67 të adresuara në vitin 2011, pra rreth 10- fish më shumë.



Grafiku 12: Prezenca e audituesve në media

Gjatë viteve 2012-2017, institucioni në përmbushje të objektivit për rritjen e

transparencës është zhvilluar në disa dimensione. Gjetjet nga auditimet, të komunikuar nëpërmjet njoftimeve për shtyp janë kthyer në këto 6 vite në lajm të ditës për televizionet, radiot dhe gazetat kryesore të vendit. Në fund të vitit 2017, institucioni ka qenë i pranishëm



Grafiku 13: Ecuria e botimeve të KLSH në vite

me rreth 100 kronika më shumë se vitin e kaluar dhe disa herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar duke gjashtëfishuar praninë e tij në mediat audiovizive, krahasuar me vitin 2010, duke u prezantuar në median e shkruar me 840 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike. Për pesë vite 2013-2017, audituesit e KLSH kanë botuar 521 artikuj, ese, editoriale, analiza

e profile në median e shkruar, të cilat janë botuar të përmbledhura në 9 volume, duke vijuar një traditë pozitive dhe inovative të nisur në vitin 2013.

Një vlerë e shtuar e KLSH-së, në gjashtë vitet e fundit (2012-2017), në fushën e komunikimit dhe të transparencës së institucionit është kolana e botimeve të saj, e cila ka arritur në fund të vitit 2017 në 83 tituj, nga vetëm 12 botime modeste të periudhës 1992-2011. Çdo vit dinamika e botimeve të institucionit rritet me 10%, duke synuar që për periudhën Janar 2012-Dhjetor 2018 të arrijë në 100 libra të botuar.

Publikimet dhe botimet e KLSH-së mbulojnë një larmishmëri të gjerë të tematikave që trajtojnë dhe, njëkohësisht, sasia e informacionit që përmbajnë këto botime konfirmojnë zbatimin në praktikë të detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit, për t'i mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë.

Komunikimi me Parlamentin, prej vitit 2012, ka njohur një dimension të ri. Viti 2016 shënoi një moment tepër të rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve KLSH-Parlament sipas standardeve më të mira europiane. Kuvendi miratoi Rezolutën për Vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015, duke vlerësuar progresin e arritur nga institucioni në përafrimin e punës së tij audituese me standardet ndërkombëtare të fushës. Kjo Rezolutë shpreh angazhimin maksimal të Kuvendit, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit si dhe për mundësinë e krijimit të Nënkomisionit parlamentar brenda Komisionit për

Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe veçanërisht për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nga institucionet ekzekutivit.

Si një risi në fushën e komunikimit, marrëdhëniet me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, SAI-t homologe si dhe organizata profesionale dhe të shoqërisë civile brenda vendit janë institucionalizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis tyre dhe KLSH. Gjatë gjashtë viteve të fundit janë lidhur 9 Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucione Shtetërore, 27 Marrëveshje me Organizata të Shoqërisë Civile, Universitete dhe Zyra të Programeve Ndërkombëtare si dhe 15 me Institucione Homologe të vendeve anëtare të BE-së dhe rajonit. Kjo qasje e ndjekur që në fillim të vitit 2012, flet për shndërrimin e KLSH-së nga një institucion i mbyllur në një institucion të hapur për vitet në vijim. Për më tepër, KLSH hapi dyert për publikun e gjerë nëpërmjet organizimit të “Java e hapur”, për një periudhë 5 vjeçare, 2012-2016, duke ofruar informacion, transparencë dhe komunikim të drejtpërdrejtë të institucionit me publikun. Kjo eksperiencë u zhvillua më tej në Nëntor vitin 2017, ku institucioni u ofroi qytetarëve shqiptar “Muajin e hapur” me shumë aktivitete, seminare dhe prezantime për ta sjellë veprimtarinë e institucionit sa më pranë qytetarit.

Instrumente të zhvillimit të kërkimit shkencor, janë konsideruar Konferencat Shkencore, të cilat ndër vite kanë trajtuar tema që mbartin motot e kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t. Në vitin 2012, tema Konferencës së I-rë “87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar”, me natyrë historike shënoi rrugëtimin për kërkimin shkencor në drejtim të çështjeve të tjera të fushës së auditimit publik që u trajtuan me profesionalizëm në konferencat e mëtejshme: Konferenca e II-të me temë “*Roli i SAI-t për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme*”, Dhjetor të vitit 2013, Konferenca e III-të, “*Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare*”, Tetor 2014, Konferenca e IV-të Shkencore “*Analiza e Riskut*”, në Qershor të vitit 2016 dhe në Tetor 2017, Konferenca e V-të Shkencore e KLSH-së me temë: “*Të auditosh për qëndrueshmëri dhe zhvillim*” e realizuar në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës dhe me Fondacionin Turk, “*Bashkëpunimi akademik për Kontabilitetin*”. Këto konferenca shkencore janë afirmuar si një forum i rëndësishëm i përvitshëm për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë, përmes prezencës së theksuar të mediave, për të transmetuar tek qytetarët arritjet, sfidat, problematikat dhe idetë e reja për menaxhimin e shëndoshë të financave publike duke përfshirë ekspertë të fushës profesionale, akademike si dhe shoqërinë civile.

Revista Shkencore “*Auditimi Publik*” e botuar për herë të parë në vitin 2012, me iniciativën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj, iu është ofruar lexuesve nga grupet e interesit, të çdo niveli si një botim periodik 4-mujor në fushën e kërkimit, shkencës dhe informacionit. Kjo revistë e botuar në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht, mbledh dhe pasqyron idetë dhe opinionet në fushën e, auditimit, kontabilitetit dhe financës publike në përgjithësi në Shqipëri dhe vende të tjera.

Raporti i Monitorimit të Planit e Zhvillimit Strategjik të KLSH 2013-2017 vlerësoi se në tërësi indikatorët e performancës të vendosur në Planin e Veprimit u arritën si në aspekte të përmbajtjes, ashtu dhe kohës së realizimit të tyre në rreth 90% të objektivave të synuara. Aktivitet që janë në process apo të përcaktuar konsistojnë në rishikimin e manualit të auditimit financiar, hartimi i rregullores dhe udhëzuesve mbi çertifikimin e audituesve, përgatitja e broshurës mbi performancën e administratës publike, ndërtimi i bazës së të dhënave për komunikimin interaktiv, dhe rishikimi i procedurave dhe përcaktimi i hapave të transparencës së auditimit.

Menaxhimi strategjik institucional është udhëhequr drejt normave dhe parimeve ndërkombëtare të auditimit të jashtëm publik, duke qenë në konvergencë të plotë me Strategjinë e Zhvillimit të EUROSAI-t dhe të INTOSAI-t dhe duke përmbushur në këtë



mënyrë pritshmëritë e palëve të interesit, përgjatë gjithë periudhës së implementimit të strategjisë. Eksperiencia në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit 2013-2017 përbën një bazë të konsoliduar për përcaktimin e drejtimeve strategjike të zhvillimit institucional për pesë vitet e ardhshme si dhe një garanci për përmbushjen me sukses të objektivave afat-gjatë.

## II. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET

Misioni kërkon që KLSH të jetë lider dhe të udhëheq nëpërmjet shembullit në sektorin publik, duke qenë një institucion i besueshëm, i pavarur e kompetent.

Gjatë viteve të fundit (2012-2017), KLSH ka ndërmarrë reforma që mbështesin përmirësimin dhe zhvillim, për të zbatuar qasje të reja e dobiprurëse të auditimit, duke synuar modernizimin e institucionit e për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me standardet ISSAI dhe qëllimet strategjike të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, si dhe për të kontribuar për një qeverisje të mirë, nëpërmjet luftës pa kompromis të rasteve sistematike të korrupsionit dhe parandalimit të tij.

Adresimi i rasteve të mashtrimit, vjedhjes e keq përdorimi të fondeve publike nga zyrtarët e çdo niveli të qeverisjes në organet ligjzbatuese kanë forcuar profilin e KLSH-së ndaj Parlamentit dhe ka krijuar besim tek qytetari shqiptar, si një hallkë aktive në zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit.

KLSH është i përkushtuar që të ruajë dhe promovojë vlerat e shoqërisë së hapur dhe të menduarit kritik, vetë-reflektues. Ai synon përsosmërinë në zotërimin e njohurive dhe aftësive audituese, kulturën për të ndjekur zhvillimin profesional dhe krijimin e dijeve të reja si dhe angazhimin në promovimin e aplikimit të tyre në praktikën audituese, veçanërisht nëpërmjet implikimeve të tyre në rastet e korrupsionit dhe keqpërdorimit të fondeve publike. KLSH në përmbushje të misionit të tij ka zhvilluar dhe do të zhvillojë instrumenta dinamikë drejt përsosjes së funksionimit, nëpërmjet vlerësimit objektiv të aktiviteteve, arritjeve dhe mangësive të tij.

KLSH synon të jetë një model i ri për auditimin publik rajonal, një qendër për studimin e sfidave bashkëkohore të auditimit në fushat ekonomike, sociale dhe politike dhe bazuar në analizën e “rrënjës” së faktorëve shkak-pasojë dhe një institucion, që udhëheq nëpërmjet shembullit për të sjellë vlerë dhe krijuar impakt pozitiv në jetën dhe dinjitetin e qytetarëve.

Misioni përbën boshtin i cili përcakton identitetin institucional që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka krijuar përgjatë rrugëtimit të tij dhe që do të sigurojë qëndrueshmërinë në të ardhmen.

**Misioni: KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që ti shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.**

Në përmbushje të misionit të tij dhe në zbatim të Ligjit nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartët të Shtetit” KLSH kryen auditime financiare, të përputhshmërisë, të rregullshmërisë, të performancës, të teknologjisë së informacionit, si edhe ndërmerr vlerësime të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe njësisë të auditimit të brendshëm të strukturave qeveritare dhe enteve të tjera publike.

**Vizioni: KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek**

**institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.**

Vizioni ynë shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në vlerësime dhe konstatime. Audituesit e jashtëm publikë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve publike të audituara për të maksimizuar vlerën e parasë publike.

**KLSH do të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi**, në shërbim të qytetarit dhe të qeverisjes së mirë, duke reflektuar vlerat dhe parimet e një SAI modern, anëtar i komunitetit të INTOSAI-t i udhëhequr nga motoja “*Të gjithë të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri*”<sup>9</sup>.

---

#### Vlerat dhe parimet

Vlerat dhe parimet e KLSH janë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), në parimet e ISSAI 12, “Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve”. Këto parime përcaktojnë mënyrën sesi institucioni duhet të performojë për të: forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të sektorit publik; demonstruar rëndësinë e vazhdueshme për qytetarët, Parlamentin dhe aktorët e tjerë; dhe, për të qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmbush misionin dhe realizon veprimtarinë në zbatim të këtyre parimeve dhe duke ruajtur vlerat e mëposhtme:

**Pavarësia:** Pavarësia është “zemra” e auditimit, dhe jetike për të fituar besimin e publikut dhe të Parlamentit, për t’i ofruar atyre informacione objektive dhe të paanshme. Pavarësia e KLSH-së parakupton që i gjithë procesi i auditimit, që nga planifikimi, realizimi dhe raportimi i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe është jashtë çdo lloj ndikimi.

**Objektiviteti:** Të gjitha raportet e KLSH-së mbi rezultatet e auditimit janë të paanshme dhe të pandikuara nga palët e interesit. Produktet e saj kanë saktësinë dhe besueshmërinë e duhur, vetëm nëse audituesit e KLSH-së zotërojnë kompetencë profesionale, dhe mbartin vlera etike dhe morale.

1. **Integriteti:** KLSH-ja angazhohet për kultivimin e vlerave më të mira etike-profesionale dhe morale për të luajtur rol kyç në luftën kundër korrupsionit. Veprimtaria e auditimit kryhet jashtë çdo konflikti interesi, dhe zhvillimi profesional parashikohet të jetë një ndër fjalët kyçe të veprimtarisë së KLSH-së.

**Përgjegjshmëria:** Në veprimtarinë e tyre, audituesit e KLSH-së veprojnë në interes të publikut dhe janë të angazhuar për të ndihmuar Kuvendin për të kontrolluar llogaridhënien e qeverisë. Pra, KLSH-ja është e përgjegjshme për të kërkuar përgjegjshmërinë e qeverisjes.

**Profesionalizmi:** KLSH udhëhiqet në veprimtarinë e tij audituese nga standardet profesionale të INTOSAI-t dhe nga praktikat më të mira të vendeve anëtare të EUROSAT-t, si dhe duke u karakterizuar nga skepticizmi profesional.

**Bashkëpunimi:** Gjatë performimit të auditimit, KLSH-ja bashkëpunon në mënyrë sistematike dhe frytdhënëse me subjektet e audituara, me strukturat e auditimit të brendshëm dhe auditues të tjerë të jashtëm, me nivelet e menaxhimit dhe me institucionet publike të pavarura si dhe me organizatat profesionale, akademike,

---

<sup>9</sup> Kongresi i XXII i INTOSAIT në Abu d’Habi, “40-VJET Deklarata e Limës 1977-2017”, Seria Botime KLSH-16/2017/83

shoqërinë civile dhe mediat. Në këtë mënyrë institucioni është pjesë aktive e bllokut të parandalimit dhe të luftës kundër korrupsionit.

**Interesi publik:** KLSH gjatë realizimit të procesit e auditimit vepron vetëm në shërbim të interesit të përgjithshëm publik. Rezultatet e punës audituese nuk ndikohen nga preferencat politike, etnike, fetare apo familjare, të stafit të KLSH-së, por udhëhiqen nga parimi i rritjes së mirëqenies së qytetarit shqiptar, nëpërmjet mirëqeverisjes dhe rritjes së eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të përdorimit të fondeve publike.

**Transparenca:** Gjatë aktiviteteve audituese, por jo vetëm, KLSH-ja e konsideron transparencën si instrument të nxitjes së llogaridhënies të administratorëve publik. Ky parim nënkupton dhe i referohet disponibilitetit të informacionit të raporteve të auditimit ndaj publikut të gjerë, në përputhje me rregullat që qeverisin këtë proces, duke e konsideruar qytetarët si aleatin më besnik në luftën kundër korrupsionit dhe papërgjegjshmërisë nga nëpunësit publik.

Qartësia dhe koherenca me standardet e INTOSAI-t të Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe gjithë korniza rregullatore e KLSH-së, mundëson mirëpërcaktimin e vizionit dhe të parimeve të funksionimit të institucionit, të cilat përbëjnë një platformë të konsoliduar për të realizuar analizën e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve për të gjitha aspektet kryesore të aktivitetit, si dhe për të përcaktuar drejtimit strategjike për një institucion modern të auditimit të jashtëm të sektorit publik.

### III. MJEDISI STRATEGJIK DHE ANALIZA SWOT

Ambienti në të cilin Kontrolli i Lartë i Shtetit funksionon, vepron e bashkëvepron karakterizohet nga një shkallë e lartë kompleksiteti, diversiteti dhe ndryshueshmërie. Studimi, analiza dhe perceptimi i drejtë i këtij ambienti, të kushtëzuar nga faktorë të brendshëm e të jashtëm, konsiderohen thelbësorë në formulimin e Strategjisë së Zhvillimit, të planit të veprimit apo në vendimmarrjen lidhur me programimin e çdo elementi apo aktiviteti të veçantë.

---

#### III.1. MJEDISI STRATEGJIK.

Zhvillimet strategjike të mjedisit në të cilin vepron dhe bashkëvepron KLSH janë analizuar me qëllim identifikimin e zhvillimeve strategjike të brendshme e të jashtme, faktorëve dhe situatave të cila kanë apo parashikohet të kenë impakt në punën dhe rezultatet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si auditimi i jashtëm publik.

Qeveria ka miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014 -2020 , duke vendosur si objektiv të përgjithshëm: arritjen e një buxheti më të mirë-balancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të ulur të borxhit publik nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe proceseve të auditimit, dhe ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e Qeverisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i përfshirë nën shtyllën 6 të kësaj strategjie, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllimin e kësaj strategjie për rritjen e transparencës për Parlamentin, sektorin financiar, komunitetin e biznesit, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun e gjerë, politikat e ndjekura dhe përpjekjet e bëra nga Qeveria për forcimin e MFP-së në vend. Respektimi i programit buxhetor afatmesëm është me rëndësi për uljen e rrezikun e angazhimeve të pafinancuara dhe të detyrimeve të prapambetura. Edhe në kuadrin e shpenzimeve të rritura në buxhetin e vitit 2018, projektet e reja të planifikuara po lënë më pak hapësirë për angazhimet ekzistuese.

Kuadri ligjor për prezantimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) përcaktohet në ligjin “Për Auditimin e Brendshëm” të vitit 2015 dhe ligjin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të vitit 2010 , i ndryshuar. Këto ligje ofrojnë një kuadër ligjor për zbatimin e tri elementëve bazë të KBFP-së, specifikisht Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), një Auditues i Brendshëm (AB) i pavarur nga pikëpamja funksionale dhe një Njësi Qendrore Harmonizimi (NjQH) për përgatitjen e metodologjive dhe standardeve për MFK-në dhe AB-në. Roli kyç dhe përgjegjësia për zhvillimin dhe zbatimin e KBFP-së i mbetet Ministrisë së Financave, e cila përmbush rolin e saj nëpërmjet operacioneve të Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit dhe Financiar Kontrollit (NJQH/MFK), Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (NJQH/AB) dhe Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, në bashkëpunim me njësitë e institucionet buxhetore.

Megjithatë, përpjekjeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e strategjisë, nuk është kuptuar ende plotësisht nga të gjitha njësitë publike roli kryesor i MKF-së për një performancë më të mirë, dhe për të siguruar më shumë transparencë, eficiencë dhe efektivitet në lidhje me shpenzimin e parave publike. Ka ende një nivel të ulët ndërgjegjësimi, duke filluar nga drejtimi më i lartë, për përfitimet nga një sistemi i shëndetshëm të kontrollit të brendshëm për përgjegjshmërinë menaxheriale. Për rrjedhojë, KLSH luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin në tërësi të proceseve të menaxhimit të riskut si dhe

bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e ekspozimit të tij në subjektet e audituara.

KLSH ka rinovuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, në prill 2017 duke nxitur kështu bashkëpunimin e ndërsjellët në funksion të rritjes së efektivitetit të të dy institucioneve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe duke forcuar dhe theksuar rolin e tyre të përbashkët në luftën kundër korrupsionit. Kjo marrëveshje synon kryerjen e aktiviteteve me interes të përbashkët duke ruajtur dhe respektuar parimin bazë të auditimit, pavarësinë si dhe në përputhje me standardet e INTOSAI-t për përdorimin e punës së auditimit të brendshëm nga auditimi i jashtëm.

*Fushat kryesore që kërkojnë më shumë vëmendje dhe që përfshijnë monitorimin e njësive jobuxhetore, menaxhimin e investimeve publike, lidhje më të mirë midis strategjive sektoriale dhe buxhetit, monitorim sistematik të detyrimeve, përmbushja e gjetjeve të auditit të jashtëm si dhe një rol më i fuqishëm i Parlamentit si institucioni kryesor i llogaridhënies. Forcimi i menaxhimit të financave publike duhet të jetë një prioritet për Shqipërinë. Arritja e vlerës më të mirë të parave që vijnë nga fonde publike është edhe rruga më efektive për përmirësimin e shërbimeve bazë për qytetarët<sup>10</sup>*

Investimet publike nëpërmjet PPP-ve janë tashmë më shumë prezent në programin e Qeverisë, dhe mbartin risqe të konsiderueshme fiskale dhe të zbatimit. Vlerësimi dhe monitorimi i projekteve PPP përbejnë një sfidë tjetër për veprimtarinë e KLSH në përmbushje të misionit të tij kushtetues.

Privatizimi i pronës shtetërore dhe në mënyrë të veçantë privatizimet strategjike mbartin risqe të konsiderueshme me impakt të rëndësishëm në buxhetin e shtetit .Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vijojë ndjekjen hap pas hapi të procesit dhe nëpërmjet raporteve të tij, me rezultatet e vlerësimeve të japë siguri të arsyeshme tek Kuvendi i Shqipërisë në lidhje me abuzimet, parregullsitë, korrupsionin apo mashtrimin financiar që mund të kenë shoqëruar këto procese.

Menaxhimi i borxhit përfaqëson një nga fushat më të rrezikuara të menaxhimit të financave publike. Politikat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duket se nuk kanë mundur të lehtësojnë nivelin e borxhit dhe për më shumë mbartin rrisqe të huamarrjes në monedhë të huaj dhe me kushte jo të buta. Po kështu, shlyerja dhe parandalimi i detyrimeve të prapambetura mbetet në një situatë jo transparente. Ndërkohë që u shënuan disa përpjekje për uljen e nivelit të detyrimeve të mbartura, nuk ka ende një menaxhim efektiv në drejtim të parandalimit të grumbullimit të detyrimeve të reja. KLSH pritet që me vlerësimet e tij të nxisë transparencën dhe përgjegjshmërinë që në procesin e planifikimit të buxhetit e deri në ekzekutimin përfundimtar të tij.

Qeverisja elektronike (e-governance) ka sjellë ndryshime të rëndësishme në ambientin e komunikimit dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Aplikimi i sistemeve elektronike në fusha të rëndësishme si prokurimi publik, sistemi i thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, apo dhe ato në dogana dhe tatime sjellin si nevojë zhvillimin e kapaciteteve të KLSH në drejtim të përdorimit të infrastrukturës së TI-së dhe auditimit të sistemeve të TI-së, si mbështetje për efektivitetin e llojeve të tjera të auditimit.

Ligji i KLSH nr.154.2014 , përcakton detyrimin për dhënien e opinionit mbi ekzekutimin e buxhetit. Po kështu nevoja për auditimin e pasqyrave financiare të subjekteve publike në

---

<sup>10</sup>Maryam Salim, përfaqësuese e BB në Shqipëri, Deklaratë përmbyllëse e ekipit për konsultimin sipas Nenit IV, për vitin 2017

pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik, kërkon që fokusi i punës audituese të jetë rritja e numrit dhe cilësisë së auditimeve financiare.

Ligji ri për vetëqeverisjen e njësive vendore si dhe kuadri ligjor për financimin e njësive vendore, përfshin angazhime të reja për KLSH në drejtim të llojit të auditimit që do të aplikohet mbi këto subjekte.

Qeveria ka adoptuar Strategjinë Kombëtare mbi Luftën Kundër Korrupsionit e cila bazohet në tre komponentë kryesorë: rritja e ndërgjegjësimit, parandalimi, dhe dënimi. Kontrolli i Lartë i Shtetit është një faktor i rëndësishëm në kuadrin e përgjithshëm të luftës kundër korrupsionit. Treguesit e arritur në zbulimin e rasteve të mashtrimit financiar dhe korrupsionit dëshmojnë rolin aktiv dhe kontributin që produktet e punës audituese kanë në identifikimin e rasteve korruptive ashtu dhe në rritjen e përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike. Si hallkë shumë e rëndësishme në zinxhirin e krijimit të një mjedisi dhe kulture antikorrupsion, KLSH do të vijojë të jetë e angazhuar plotësisht dhe efektivisht në këtë luftë, jo vetëm me zbulimin por dhe në parandalimin e korrupsionit në çdo qelizë të qeverisjes.

---

### III.2. ANALIZA SWOT

KLSH është e ndërgjegjshme se është e pamundur të projektosh një të ardhme të suksesshme pa vlerësuar më parë në mënyrë analitike faktorët që e ndihmojnë, frenojnë apo e pengojnë procesin, nga çdo këndvështrim dhe në çdo pikëpamje të të gjithë burimeve të brendshme e të jashtme, por duke u fokusuar qartësisht në qëllimet dhe objektivat afat-shkurtër dhe afatgjatë, si dhe në sfidat e së ardhmes.

Si një mjet për planifikimin strategjik, KLSH ka përdorur Analizën SWOT për të vlerësuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që janë pjesë e veprimtarisë së saj, pra çka ekziston në kushtet aktuale dhe që kanë apo mund të kenë impakt të konsiderueshëm në aspiratat dhe qëllimet strategjike të institucionit.

Kjo analizë ka mundësuar që KLSH-ja të krijojë njohje të thellë dhe të plotë të gjithë faktorëve të përfshirë në procesin e vendimmarrjes strategjike dhe që konkretizohet në këtë Strategji Zhvillimi për periudhën 5 vjeçare që përfshin vitet 2018-2022.

Analiza SWOT është përdorur si një qasje tradicionale për të humultuar dhe analizuar eksperiencat pozitive dhe jo pozitive, të cilat mundësojnë identifikimin e alternativave të reja dhe rrugë, të sigurt për zhvillimin dhe modernizimin e institucionit në të ardhmen e afërt dhe afatgjatë. Gjetjet e kësaj analize kanë shërbyer për përcaktimin e qartë të qëllimeve dhe objektivave strategjike të përvijuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH për vitet 2018 -2022. Analiza SWOT e paraqitur në vijim, tregon se objektivat kryesorë të strategjisë duhen fokusuar në rritjen e eficiencës drejtuese, përmirësimin e kapaciteteve audituese dhe rritjen e rolit të komunikimit brenda dhe jashtë institucionit. Kjo analizë, duhet plotësuar me një analizë më rigorozë rrisht për të kuptuar më në thellësi aspektet e cënueshme organizacionale, si edhe për të përfutur një metrikë më saktë të objektivave që duhen vendosur.

Më poshtë Analiza SWOT e strukturuar sipas kategorive përkatëse paraqitet në vijim:



## Analiza SWOT - Strategjia 2018 2022

|  | Fuqite   | Dobësi të   |
|--|--|---|
| Aspekti ligjor & rregullativ   | Adoptimi i Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI (Ligj, Rregullore, Manuale auditimi)   | Kuadri rregullator dhe manualet auditimi në proces rishikimi  |
|  | Procese pune dhe mbështetëse të përshkruara dhe detajuara në dokumente strategjike, taktike dhe operacionale.  | Cikël reaktiv i rishikimit dhe përditësimit të rregulloreve, manualeve, etj.A   |
|  | Adoptim periodik i SAI PMF përmes modelit hibrid për të shmangur devijimet në vetëvlerësim.  | Sistem jo i konsoliduar vetëvlerësimi për zbatimin e PMF  |
| Aspekti organizativ  | Hierarki e qartë për arrijtjen e objektivave institucionale, me tre linja operacionale dhe një mbështetëse, si edhe me 5 nivele horizontale.   | Ineficiencë hierarkike në disa hallka të saj  |
|  | Investimet në rritjen e kapaciteteve audituese në tërësi për çdo lloj auditimi, duke u fokusuar në drejtim të auditimeve të performancës dhe të IT, si qasjet audituese më produktive ndaj sfidave të kohës. |   |
|  | Egzistenca dhe përdorimi i instrumentave të duhur për rritjen e integritetit dhe etikës së stafit auditues.  | Pamjaftueshmëri kapacitetesh njerëzore (në sasi) për të mbuluar me auditim të gjithë sfidat që ofron realiteti shqiptar.            |
|  | Mbështetja në një aparat metodologjik të zhvilluar dhe të ngjashëm me atë të institucioneve më të zhvilluara homologe.   | Rezistenca për të ndryshuar, ndikimi i traditës së trashëguar në praktikën audituese.   |
|  | Kultura institucionale e liderit në favor të transparencës dhe llogaridhënies së shëndetshme brenda dhe jashtë KLSH së.  | Dilegimi i dy apo më shumë detyrave paralele tek vartësi (për efekte të mbingarkesës), duke sjellë shpërqëndrim nga puna audituese. |
|  | Politika për motivimin dhe promovimin e rritjes në karrierë të stafit bazuar në meritë dhe aftësi.   | Mospërputhja e konstatuar e trajnimeve me nivelin dhe perspektivën e audituesve.  |
|  | Ndërtimi i strukturës institucionale bazuar në filozofinë e rritjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm në të gjitha dimensionet. Udhëheqje përmes shembullit.   |   |
| Menaxherë me grada shkencore, përvojë të gjatë institucionale dhe njohuri të thelluara në fushën e auditimit.  |  |   |
| Auditues me përvojë dhe formim të larmishëm akademik.  |  |   |
| Testime periodike të strukturuar për rifreskimin dhe shtimin e njohurive audituese me synim mbajtjen e postit aktual të punës dhe avancimin në karrierë. | Vëshirësi në përthithjen e qasjeve inovative në auditime.  |   |

|                     |  |   |
|---------------------|--|---|
| Aspekti financiar   | Buxhet normal për të kontraktuar ekspertizë të jashtme dhe motivuar financiarisht punonjësit.                            | Mungesa e një politike motivimi financiar të lidhur me performancën në punë.                        |
| Aspekti operacional | K ryerja e auditimeve të përbashkëta dhe paralele me SAI me përvojë në fushën e auditimeve të performancës dhe të tjera. | Vështirësi në implementimin e SSAI -eve.  |
|                     | Mentorim i strukturuar i audituesve të rinj nga kolegë me përvojë.   | Vështirësi në dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara.               |
|                     | Punë audituese e planifikuar dhe e kontrolluar në kohë.  | Studim i pamjaftueshëm i dokumenteve audituese dhe qasje jo e plotë ndaj problemeve të konstatuara. |
|                     | Impakt domethënës tek subjektet e audituara dhe palët e interesit.   | Mangësi në aplikimin e auditimit me bazë rrisht dhe mangësi në metodologjinë audituese.             |
|                     | Bashkëpunim me strukturat e auditimit të brendshëm në subjekte.  | Siguri e pamjaftueshme e kontrollit të cilësisë.  |
|                     | Bashkëpunim me media, akademikë, ekspertë dhe OJF.   | Mangësi në formulimin e duhur dhe të qartë të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve.            |

#### IV. PARTNERËT KRYESORË STRATEGJIKË

Grupet e interesit kanë një rol të rëndësishëm për KLSH-në për përmbushjen e misionit kushtetues duke u rritur në të gjithë aspektet institucionale. Zhvillimi shumë dimensional dhe efektiv i marrëdhënieve bazohet në ruajtjen e pacënuar të pavarësisë, si parimi themelor i funksionimit të institucionit suprem të auditimit. KLSH-ja konsideron jetike zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë së Komunikimit, si pjesë e rëndësishme në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjik të zhvillimit, si dhe për progresin e suksesshëm në përmbushje të misionit kushtetues, në mbrojtje të interesave të taksapaguesve shqiptarë.

##### IV.1. Qytetari Shqiptar

Qytetari është përdoruesi më i rëndësishëm i produkteve të KLSH-së si dhe pala e interesit më prioritarë në tërësinë e aktorëve kryesorë me ndikim në efektet e ambientit të jashtëm mbi veprimtarinë e KLSH-së.

KLSH ndjek parimin e “Partneritetit me Qytetarin dhe Qeverisjes së Hapur”. Në funksion të misionit të tij, KLSH synon t’u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve si në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte duke u siguruar mundësinë dhe aksesin e plotë qytetarëve për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja.

Institucioni synon, që nëpërmjet rezultateve të auditimeve, t’i përgjigjet pritshmërive dhe kërkesave të qytetarëve dhe taksapaguesve për mirëqeverisje dhe luftë efektive ndaj korrupsionit. Krijimi i besimit të publikut kërkon që KLSH të jetë një SAI modern, transparent dhe i përgjegjshëm. Këto cilësi KLSH i arrin nëpërmjet rritjes së vazhdueshme profesionale, jo vetëm nga pikëpamja e ekspertizës por edhe të infrastrukturës së auditimit si dhe të qenit transparent me vetveten dhe me publikun. Veprimtaria “Muaji i hapur” e sjell KLSH-në edhe më pranë publikut shqiptar, dhe anasjelltas, duke u kthyer në një urë lidhëse, e si e tillë do të organizohet në çdo vit të Strategjisë së ardhshme. Ajo që synohet përmes transparencës, si “watchdog” dhe agjent i Kuvendit dhe qytetarëve, është jo vetëm përcjellja e informacioneve dhe raporteve mbi aktivitetin e institucionit, por mbi të gjitha, të nxisë pjesëmarrjen e publikut në qeverisje.

---

## IV.2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka rol mjaft të rëndësishëm në sigurimin e pavarësisë dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Marrëdhëniet e KLSH me Institucionin e Presidentit janë forcuar gjatë rrjedhës së viteve duke krijuar një bazë të qëndrueshme në mbrojtje të paprekshmërisë së pavarësisë së Institucionit Suprem të Auditimit.

Institucioni i Presidentit është pjesë e rëndësishme në network-un shumëdimensional të marrëdhënieve të KLSH duke u bërë shpesh vendimtar në iniciativat për zhvillim të institucionit të KLSH.

KLSH njih dhe vlerëson të rëndësishme maksimale mbështetjen për miratimin e Ligjit nr.154, datë 27.11.2014 “ Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” të Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët bënë të mundur që KLSH të jetë një institucion veprimtaria e të cilit mbështete në një ligj bashkokohor dhe që i hapi rrugën reformimit dhe modernizimit të funksionit të auditimit publik në Shqipëri.

Marrëdhëniet efektive dy palëshe shkojnë përtej rritjes së ndërgjegjësimit mbi rolin dhe rëndësinë që auditimi i jashtëm publik i kryer nga KLSH ka në mirëqeverisjen e vendit, në kërkesën për përgjegjshmëri dhe transparencë në pëdorimin e pasurisë kombëtare dhe fondve publike.

Duke mbajtur të përgjegjshëm institucionet në qëndrimin ndaj KLSH, Presidenti është një garanci e sigurt në mbrojtje të vlerave dhe parimeve mbi të cilat funksionon KLSH, support moral dhe parimor për ruajtjen e KLSH të paprekur nga qasje të ndryshme politike apo tradicionale që influencojnë strukturat institucionale dhe kornizat e përgjegjshmërisë.

---

## IV.3. Kuvendi i Shqipërisë

Parimet Themelore të vendosura në Deklaratën e Limës (ISSAI 1) dhe Deklaratën e Meksikos (ISSAI 10), kërkojnë që SAI duhet të vendosë dhe të mbajë komunikim dhe marrëdhënie efektive me Kuvendin dhe komisionet përkatëse të tij. Në mënyrë të veçantë, ISSAI 20, cilëson se *"SAI të mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të ndërmarrin veprimet e duhura"*. Mbështetur në këto parime, KLSH-ja, vitet e fundit, ka punuar për të forcuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me Kuvendin dhe veçanërisht me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, duke zhvilluar dhe zbatuar instrumente dhe strategji efektive komunikimi. Për të rritur eficiencën e punës audituese dhe zbatimin e rekomandimeve në mbështetje të qeverisjes së mirë, duke shërbyer si aktorë kryesorë të transparencës dhe llogaridhënies.

Cilësia dhe besueshmëria e raporteve të auditimeve të KLSH po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e parlamentarëve, duke rritur mundësinë e funksionimit të mekanizmave të “Trekëndëshit të Llogaridhënies” (SAI-Parlament-Ekzekutiv), pasi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit orientohen pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problematikave të qeverisjes publike, duke përforcuar kështu mirëqeverisjen.

Raportet kryesore drejtuar Kuvendit, ai i realizimit të Buxhetit Faktik të Shtetit për vitin paraardhës dhe Raporti Vjetor i Performancës së KLSH, në rolin e institucionit si agjent i Kuvendit për mirëmenaxhimin e pasurisë publike, udhëhiqen nga thellësia e argumentit dhe gjetjes audituese, dobia sa më e plotë e rekomandimeve, në përmirësim konkret të menaxhimit

të fondeve publike, sipas orientimeve të standardeve ISSAI, duke siguruar drejtpërdrejtshmëri dhe lexueshmëri nga anëtarët e Kuvendit. Në këto marrëdhënie KLSH-ja është mbështetur dhe do të mbështetet në ISSAI 12, që përcakton se *"SAI duhet të zhvillojë marrëdhënie profesionale me komisionet përkatëse të mbikëqyrjes legjislative dhe bordet e drejtimit dhe bordet e njëjse të audituara për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të ndërmarrin veprimet e duhura."*

---

#### IV.4. Shoqëria civile, Mediat dhe Shoqatat profesionale të fushës

Shoqëria civile dhe mediat janë konsideruar si faktor dhe aktor shumë të rëndësishme nga KLSH. Faktor për nxitjen e përgjegjshmërisë së institucionit dhe aktor për rritjen e diapazonit të efekteve të veprimtarisë së audituese. Në tërësinë e vetë përbëjnë pjesë interaktive të ambientit ku KLSH vepron, që nënkupton reagimin ndaj ndryshimeve në mjedisin ku vepron dhe rezeqeve në zhvillim.

Organizatat e shoqërisë civile, përfshirë dhe shoqatat profesionale janë një partner mjaft i vlefshëm për KLSH-në. Vendosija e urave të komunikimit, mbi baza të rregullta dhe frekvente ndihmon KLSH-në të njihet me problemet e qytetarëve duke identifikuar se ku shërbimet e qeverisë nuk janë ato të pritshmet dhe ku efienca e fondet publike janë në rrezik. Ky rol vijon dhe më tej në përfundim të auditimeve kur këta aktorë mund të ndikojnë ndjeshëm në sigurinë se mesazhet dhe rekomandimet e KLSH-së janë gjerësisht të njohura, janë kuptuar siç duhet dhe po zbatohen.

Duke komunikuar në mënyrë efektive, KLSH, shërben për këta aktorë si një burim i besueshëm, i pavarur, objektiv dhe këshillues për të mbështetur ndryshimet e dobishme në qeveri dhe në subjektet e sektorit publik. Njëkohësisht, organizatat e shoqërisë civile (OJQ) si dhe palë të tjera të interesit si: media, organizatat kërkimore po ashtu dhe nga vetë sektori privat janë të njohura për rolin e rëndësishëm që luajnë në nxitjen e qeverisjes efektive duke promovuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve publike, dhe gradualisht duke e rritur këtë rol nëpërmjet analizave, shqyrtimeve dhe ndërmarrjes së veprimeve bazuar në produktet e KLSH-së.

KLSH ka përdorur mekanizma dhe instrumenta të angazhimit, duke i bërë pjesë të fazave të ndryshme të ciklit të auditimit. KLSH mbështetur në iniciativat inkurajuese të INTOSAI-t ka filluar të aplikojë modelet e njohura ekzistuese të kontributit, angazhimit, si dhe pjesëmarrjes, të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe mediave në veprimtari të ndryshme me përfitim të dyanshëm.

Gjatë periudhës 2012-2017 janë nënshkruar 27 marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet KLSH dhe organizata të njohura të shoqërisë civile dhe universitete. Ky partneritet buron nga nevoja e ndërsjellë që kanë palët për informacion. KLSH merr nga shoqëria civile dhe mediat informacione të vlefshme, të cilat mund t'i bëjë subjekte të auditimit, ndërkohë që mediat, në respekt të detyrimit dhe profesionit për të informuar qytetarët, marrin nga KLSH informacione mbi rezultatet e auditimit. Ky proces i ndërsjellë i shërben edhe rritjes së besimit të publikut në institucionin e KLSH-së, si dhe monitorimit të tij nga publiku, ashtu edhe rritjes së besimit të publikut ndaj qeverisjes.

Shoqatat profesionale të fushës vlerësohen nga KLSH-ja si një partner i rëndësishëm, veçanërisht Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) si dhe shoqatat e ndryshme të kontabilistëve, Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM), Shoqatën e Kontabilistëve dhe Adituesve të Çertifikuar të Kosovës dhe Institutin për Kontabilitet, Auditim dhe Financa, IKAF. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me këto shoqata kanë mundësuar zhvillimin e veprimtarive me interes të

ndërsjellë, ku veçanërisht spikasin organizimi i Konferencat Shkencore të përbashkëta, trajnime apo tryeza të përbashkëta diskutimi dhe rishikime nga kolegët, etj.

KLSH ka institucionalizuar bashkëpunimin me institucionet akademike, sidomos me universitetet publike në Shqipëri, si Universitetin e Vlorës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Universitetin “Luarasi” dhe Universitetin “Mesdhetar”, Universitetin e Tiranës dhe në veçanti me Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Gjeologji Minierave, të cilat kanë qenë reciprokisht dobiprurëse.

---

#### IV.5. SAI-t homologe dhe Organizatat Ndërkombëtare të Auditimit - Binjakëzimi me NIK-un e Polonisë

KLSH është anëtar i INTOSAI-t që nga viti 1984 dhe anëtarësimi në këtë organizatë shtron detyra për të respektuar standardet e saj, duke i zhvilluar ato në përputhje me kushtet e vendit tonë. KLSH, që prej vitit 1993, është, gjithashtu, anëtar i, Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Pas viteve 2012, këto anëtarësime njohën pjesëmarrje të gjerë të institucionit në Kongreset, Konferencat, seminarët dhe takimet e punës të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

KLSH përfaqësohet me pjesëmarrje aktive e audituesve, në grupet e punës të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, ku ekspertët e KLSH japin kontributin e tyre prej disa vitesh si:

Task Force për Auditimin dhe Etikën;

Task Force për Auditimin e Bashkive (TFMA);

Task Force për Auditimin e Mjedisit;

Grupi i Punës së EUROSAI-t për auditimin e fondeve të alokuara për katastrofat; Grupi i Projektit të EUROSAI për “Roli i SAI-ve në shpërndarjen e kulturës së integritetit”;

Grupi i Projektit të EUROSAI për Qëllimin Strategjik 1: Mbështetja e auditimeve efektive, inovative dhe adekuate përmes promovimit dhe ndërmjetësimit të bashkëpunimit profesional;

Grupi Projekt i EUROSAI për Qëllimin Strategjik 2 : Ndhimesa ndaj SAI-ve në përballjen mundësitë dhe sfidat të reja nëpërmjet mbështetjes në zhvillimin e kapaciteteve të tyre institucionale; dhe,

Grupi i Punës për Auditimin e TI.

Përveç kësaj, KLSH, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me SAI-t partnere në Evropë, ka realizuar trajnime intensive të stafit të saj, duke rritur kapacitetet audituese dhe bashkëpunuar sidomos në dy vitet e fundit, në kryerjen e auditimeve paralele dhe të përbashkëta të performancës me SAI evropiane të zhvilluara dhe me SAI-t e rajonit.

Gjatë periudhës 2012-2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka nënshkruar 14 marrëveshje bashkëpunimi me SAI-t homologe të: Polonisë, Austrisë, Kroacisë, Sllovenisë, Turqisë, Kosovës, Bullgarisë, Cekisë, Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë, Kuvajtit, Hungarisë dhe Qipros, duke plotësuar hartën rajonale të partneritetit me thaujse të gjitha SAI-et e vendeve të rajonit, ku natyrisht e para është ajo me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Këto marrëveshje partneriteti janë konkretizuar në fusha të tilla si, shkëmbimi i informacionit, trajnime, veprimtari të përbashkëta audituese rajonale, etj.

Projekti i Binjakëzimit IPA 2013, “Forcimi i kapaciteteve të auditimit jashtëm”, ka ofruar në KLSH përfitime të natyrës specifike të auditimit dhe asistencës teknike, i cili u mundësua nëpërmjet SAI-t me eksperiencë, si NIK-u i Polonisë dhe ekspertë të tjerë që kanë ekspertizë në

fushën e zhvillimit dhe të modernizimit të SAI-ve. Implementimi për dy vjet i Projektit të Binjakëzimit u fokusua në disa objektiva kryesorë të cilat mbuluan fushat e:

Përmirësimin e kornizës ligjore për auditimin;

Zhvillimin e metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve të raportimit;

Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e impaktit të rezultateve të auditimit.

Projekti do të vijojë gjatë vitit 2018 dhe mbi bazën e eksperiencës së partnerëve të Projektit të Binjakëzimit, SAI-t Polak dhe SAI-t Kroat, produktet e Projektit do të forcojnë zbatueshmërinë e rekomandimeve tona, si mjet thelbësor për të ndikuar në mirëqeverisjen publike të vendit. Megjithatë, parimi themelor i programit të binjakëzimit është përfshirë tashmë në axhendën e KLSH, me qëllim që të synohet qasja për të sjellë në veprimtari e projekte të përbashkëta midis KLSH-së (si përfitues) dhe SAI-ve të vendeve anëtare me qëllim që të zhvillojnë më tej kapacitetet institucionale bazuar në bashkëveprimin real. Kjo mënyrë bashkëpunimi përbën një instrument efektiv për modernizimin e institucionit.

---

#### IV.6. Zyra e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së dhe Gjykata Evropiane e Audituesve

Në modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë dhënë një kontribut të çmuar Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), dhe Zyra e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së (GAO), nëpërmjet ofrimit të programeve afatgjatë të intership-eve për periudha disa mujore.

Falë kësaj asistence, në KLSH po krijohet një gjeneratë e re audituesish me parametrat e kolegëve të tyre evropianë. Deri në fund të vitit 2017, kanë marrë pjesë 10 auditues dhe dy të tjerë janë të miratuar. Internshipi në Gjykatën Evropiane të Audituesve në Luksenburg, konsiderohet një mjet shumë i rëndësishëm për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së, për audituesit e SAI-ve të vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së.

Marrëdhëniet me Zyrën e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së, rifilluar në vitin 2013, pas një shkëputje disa vjeçare, janë kthyer tashmë në një nga bashkëpunimet më produktive për KLSH. Programi studimor 5-mujor me Qendrën e Ekselencës së GAO-s i hartuar për të forcuar kapacitetet e SAI-ve dhe për të rritur llogaridhënien dhe mirëqeverisjen, është një burim i zhvillimit të kapaciteteve audituese në KLSH. Deri tani, KLSH është përfaqësuar me 3 auditues ndërkohë që dy auditues të tjerë do të kryejnë programin në gjysmën e parë të vitit 2018. Pjesëmarrësit kanë mundësi të njihen me përvojën amerikane të auditimit, me qëllim zhvillimin e teknikave dhe metodologjive audituese sipas praktikave më të mira të GAO-së për të sjellë ndryshim dhe për ta përcjellë dijen e përfituar në SAI-et e vendeve të tyre respektive.

Në këtë kontekst, implementi i Standarteve të Auditimit të Qeverisë (*Yellow Book*) dhe Standardet për Kontrollin e Brendshëm në Qeverinë Federale (*Green Book*) të përkthyer dhe të adoptuara nga KLSH-ja do të jenë pjesë e kuadrit të standardeve mbi të cilat do të mbështetet puna e audituesve publik.



---

#### IV.7. Delegacioni i BE-së në Shqipëri, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Komisionin Evropian, Programi SIGMA dhe Agjencinë e Zhvillimit Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara, USAID

Bashkimi Evropian dhe Programi SIGMA janë partnerë shumë të rëndësishëm të KLSH. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Komisionin Evropian (DG-Budget) ka dhënë kontribut të vyer për miratimin e ligjit të ri të KLSH-së nga Kuvendi i Shqipërisë. DG Budget dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri ka mbështetur projektin IPA 2013 të KLSH-së, “*Mbi forcimin e kapaciteteve të auditimit të Jashtëm në Shqipëri*”, i cili po implementohet aktualisht në KLSH në bashkëpunim me SAI-n Polak (NIK) dhe atë Kroat.

SIGMA është një nga partnerët kryesorë dhe ndër më të rëndësishmit e KLSH, jo vetëm për kontributin e tij në monitorimin dhe vlerësimin e përvitshëm të aktivitetit të KLSH që prej vitit 2000, por edhe për ndihmesën thelbësore që ka dhënë gjatë procesit të miratimit të Ligjit të ri organik të institucionit në vitin 2014, si dhe realizimit të trajnimeve cilësore në fushën e auditimit të performancës, të auditimit financiar, të përputhshmërisë dhe të teknologjisë së informacionit. KLSH do të vazhdojë bashkëpunimin intensiv me SIGMA edhe përgjatë hartimit dhe implementimit të Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022. SIGMA është padyshim një garanci e zhvillimit cilësor të kapaciteteve audituese të institucionit dhe të rritjes së transparencës së tij.

Memorandumi i Bashkëpunimit midis KLSH-së, Avokatit të Popullit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit dhe USAID, e rendit Agjencinë e Zhvillimit Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara, ndër partnerët aktivë të KLSH.

USAID ofron asistencë për KLSH nëpërmjet Projektit “Transparenca në Sistemin Shëndetësor”, i cili ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët shqiptarë me fokus luftën ndaj korrupsionit duke u mbështetur në dy shtylla: përmirësimin e transparencës për funksionet qeveritare dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të pavarura qeveritare, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe media-s për të kërkuar një qeverisje më të përgjegjshme në sektorin shëndetësor.

Duke vendosur “ura” komunikimi efektive ndërmjet institucioneve të ndryshme, Projekti synon të përmirësojë koordinimin ndër-institucional dhe të rrisë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe media-n për të rritur ndërgjegjësimin rreth shkallës së korrupsionit në sistemin shëndetësor dhe trysinë për reforma për rritjen e transparencës.

Ky bashkëpunim konkret me USAID-in përbën një eksperiencë të dobishme për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në fushat e tjera, në zbatim edhe të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe kryesisht të GAO-s së SHBA-së.

## V. FOKUSI STRATEGJIK I KLSH - QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2018 – 2022

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vendosur fokusin strategjik të zhvillimit i udhëhequr nga konceptet dhe parimet e adresuara në dy Rezolutat e rëndësishme të Asamblesë së Përgjithshme, të cilat kanë pranuar dhe theksuar “...rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin e një administrate publike efektive dhe të përgjegjshme, të favorshme për realizimin e prioriteteve të zhvillimit. Ato luajnë një rol kritik në luftën kundër mashtrimeve financiare dhe praktikave të korruptuara”. Gjithashtu, moto e Kongresit të XXI – të INCOSAI-t: “Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes së Mirë Kombëtare”<sup>11</sup>, përbën thelbin e qëllimeve strategjike dhe objektivave të zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022.

KLSH, si partner aktiv i rrjetit ndërkombëtar të institucioneve supreme të auditimit, ka integruar në kornizën e zhvillimit strategjik mesazhet e përciella nga Kongresi i XXII i INCOSAI-t « Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-et) në shërbim të qytetarëve » dhe «Të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri».

**“KLSH shërbestar i qytetarit”** do të jetë motoja e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022

Kjo moto është shprehje e eksperiencës së akumuluar përgjatë implementimit të Planit Strategjik të pesë viteve të kaluara dhe nxitje për të konsoliduar aktivitetin në të gjitha dimensionet për vitet 2018-2022, duke informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë qendrore e vendore, si dhe të njëjstëve të tjera publike për përdorimin e parave publike me ekonomicitet, efektivitet dhe efizienzë, në përputhje me praktikën me të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mire, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë së Zhvillimit të periudhës së mëparshme identifikoi eksperiencat e rëndësishme në këto vitet e fundit. Ky monitorim konfirmoi gjithashtu se KLSH ka treguar profesionalizëm si në parashikimet për zhvillimet e saj strategjike, ashtu dhe në vënien në jetë dhe zbatimin e suksesshëm të tyre. Monitorimi vlerësoi progresin e bërë kundrejt objektivave të planifikuara po ashtu dhe efektivitetin e politikave të vendosura në arritjen e vizionit dhe misionit për të përmbushur rolin dhe mandatin kushtetues të KLSH-së në pesë vite.

Mbi të gjitha, analiza e progresit konfirmoi ndryshimin institucional që reforma dhe implementimi i Strategjisë për vitet 2013-2017 solli në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ndryshim që sot mund të matet me shifra dhe fakte të publikuara dhe të vlerësuara nga mbikëqyrësit si Kuvendi i Shqipërisë, strukturat vlerësuese të Komisionit të BE-së, SIGMA, qytetarët dhe nga komuniteti i INTOSAI-t, EUROSAT-t, homologët e vendeve të tjera apo shoqatat profesionale.

Ka një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet konkluzioneve të nxjerra nga analiza e zhvillimit dhe arritjet gjatë implementimit të Planit Strategjik 2013-2017 dhe projektimit të fokusit të strategjisë së zhvillimit për pesë vitet në vijim. KLSH ka vendosur tashmë një bazë solide mbi të cilën po ndërtohet strategjia e së ardhmes, që përfaqëson mënyrën se si do të menaxhohet ndryshimi nga arritjet aktuale drejt pritshmërive. Zhvillimet për periudhën e ardhshme janë

<sup>11</sup>Deklarata e Kongresit të XXI të INCOSAI-t, Pekin, Tetor 2013, “40-VJET Deklarata e Limës 1977-2017”  
Seria Botime KLSH-16/2017/83

përcaktuar mbështetur në vlerësime dhe analiza, në referencë të asaj se çfarë është bërë dhe çfarë synohet të arrihet nga KLSH, gjithnjë drejt përbushjes së misionit dhe vizionit e duke ruajtur e zhvilluar vlerat e parimet tona.

Objektivi i tretë i ISSAI-t 12, sipas të cilit “SAI duhet të jetë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit”, përbën boshtin mbi të cilin është hartuar Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së dhe që synon të sigurojë: transparencën dhe përgjegjshmërinë e duhur; qeverisjen e mirë; pajtueshmërinë me Kodin e Etikës; ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet promovimit të të mësuarit dhe shpërndarjes së njohurive.

Ky vizion konkretizohet në **tri qëllime strategjike**, në të cilat KLSH do të fokusojë veprimtarinë e saj për vitet 2018-2022 dhe që konsistojnë në:

#### **Qëllimi 1:**

Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të

#### **Qëllimi 2:**

Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.

#### **Qëllimi 3:**

Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit

### Qëllimi 1: Rritja e Impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të

Puna audituese dhe produktet e saj janë “shtylla kurrizore” e aktivitetit institucional. Përveçse e fokusuar në auditimet tradicionale të përputhshmërisë dhe ato financiare, KLSH do të vijojë zgjerimin e fokusit të saj në auditimet e performancës dhe IT, duke përfshirë në secilin prej tyre konsiderata për ekonomicitetin, eficiencën, efektivitetin, etikën, mjedisin (environment) dhe energjinë.

#### 1.1. Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH

Pavarësia dhe mandati i Kontrollit të Lartë të Shtetit është e sanksionuar në Kushtetutë dhe në Ligjin e tij Organik, duke u konsideruar si kusht i domosdoshëm për përbushjen e misionit dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave strategjike përgjatë zhvillimit ndër vite.

Niveli aktual i pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit është vlerësuar nëpërmjet një “Peer Review”/ Rishikim nga Kolegjet të realizuar gjatë vitit 2016 nga ekspertët e Gjykatës së Auditimit të Austrisë në kuadrin e INTOSAI-t. Raporti me konkluzionet dhe rekomandimet e Rishikimit nga Kolegjet<sup>12</sup> për pavarësinë e ALSAI-t, do të shërbejnë për KLSH si bazë mbi të cilën KLSH do të propozojë ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore përkatëse në mënyrë që të gjitha parakushtet që konsiderohen të domosdoshme për pavarësinë e institucionit të sigurohen. Këto ndryshime konsistojnë në:

Përdorimin e instrumenteve si një garanci shtesë që do të japë siguri të mëtejshme se KLSH duhet të ketë në dispozicion burimet njerëzore, materiale dhe monetare të nevojshme dhe të arsyeshme për kryerjen e plotë të auditimeve. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë “de facto” autoriteti që duhet të vendosi mbi disponibilitetin e burimeve të institucionit të auditimit të jashtëm publik.

<sup>12</sup> Raporti Final i “Rishikimit nga Kolegjet” mbi Pavarësinë e ALSAI-t, ACA. Gjykata Austriake e Auditimit, Qershor 2017, www.klsh.org

Qartësimin dhe adresimin e fushave të pambuluar me auditim nga KLSH, për një qasje të pakufizuar dhe të pavarur në auditimin e institucioneve, organizatave dhe kompanive që janë përdorues të fondeve publike, pavarësisht statusit të tyre, përfshirë edhe përfituesit e fondeve të asistencës së Bashkimit Evropian deri në nivelin e përdoruesit më të fundit. Në këtë mënyrë jepet siguri e arsyeshme dhe e pavarur për palët e interesit të nivelit kombëtar, Kuvendin, dhe ndërkombëtar, Komisionin Evropian në mbrojtje të interesave financiare të tyre.

---

### 1.2. Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit

Ky objektivi synon që të përmirësojë cilësinë dhe të rrisë efektivitetin e punës audituese. Aplikimi i saj kërkon ndryshim rrënjësor të qasjes audituese në praktikë. Deri tani aplikimi i qasjes së bazuar në risk është shtrirë mbi fazën planifikimit vjetor të KLSH-së. E aplikuar për herë të parë me asistencën e ekspertizës së Projektit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm” për hartimin e Planit Vjetor të Auditimit të KLSH për vitin 2017, kjo qasje do të shtrihet dhe zgjerohet më tej në çdo fazë të angazhimeve të auditimit.

KLSH synon të konsolidojë auditimin mbi bazë risku si qasje të përshtatshme dhe shumë të rëndësishme për të gjitha llojet e auditimit që aplikon. Kjo kërkon krijimin e një strukture të veçantë (permanente ose ad hoc) e cila do të zhvillojë Udhëzues të veçantë për Vlerësimin e Riskut në Auditim, trajnojë stafin për këtë çështje, sa të rëndësishme aq dhe të vështirë e komplekse, si dhe të ndjekë në vijimësi implementimin e duhur të ABR në praktikë. Qasja nga poshtë - lart e analizës së riskut në KLSH duhet të balancohet me rritjen e strukturës lart - poshtë të analizës së riskut.

Objektivat strategjik të aplikimit të qasjes së auditimit mbi bazë risku për KLSH-në përfshijnë:

Analiza e riskut dhe përdorimi i regjistrit të riskut qendror si pjesë kryesore e procesit të planifikimit vjetor, nëpërmjet hartimit të një table të dhënash, e cila do të dokumentojë dhe përmbledhë të dhënat dhe rezultatet e analizës së riskut.

Mbështetja e gjyqimit profesional mbi të dhënat sasiore për procesin e përzgjedhjes së subjektit të auditimit.

Ruajtja e koherencës ndërmjet zhvillimeve institucionale, regjistrit qendror të riskut të KLSH-së dhe analizës së zhvilluar nga njësitë publike – subjekt i auditimit.

Sfida kryesore dhe objektivi strategjik i institucionit është hartimi i “Hartës së Riskut në nivel Kombëtar” si një dokument gjithpërfshirës që përcakton dhe vlerëson riskun politik, ekonomik, social, teknologjik dhe mjedisor në të gjithë sektorin publik në Shqipëri për periudhën e ardhshme, kërkon bashkëpunim të gjerë jo vetëm midis institucioneve, por mbi të gjitha me studiuesit e profesoratin e universiteteve dhe institucionet e kërkimit shkencor.

---

### 1.3. Kryerja e Auditimit Financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit

Auditimi financiar përbën një nga aktivitetet audituese më tradicionale nga pikëpamja e historisë, por që përsoset në mënyrë dinamike nga zhvillimet në fushën e raportimit financiar, përfshi rolin gjithnjë e më të madh të teknologjisë së informacionit në këtë fushë, si dhe ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Plani strategjik i KLSH merr në konsideratë dhe zhvillimet e ndodhura dhe të pritshme në fushën e raportimit financiar në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë, të cilat risin përgjegjësinë e KLSH për forcimin e mëtejshëm të

kapaciteteve në zhvillimin e auditimit mbi raportimin financiar në këtë sektor. KLSH në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka për kompetencë auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe vendore si dhe dhënien e opinionit mbi to. Kontrolli i Lartë i Shtetit, çdo vit, jep opinion në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar të shtetit.

Aktualisht raportimi financiar nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri realizohet mbi bazën e mjeteve monetare, por me elementë të administrimit të aktiveve, të angazhimeve, debitorëve dhe kreditorëve. Raportimi financiar në sektorin publik është i orientuar drejt mënyrës së buxhetimit dhe kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit. Si rrjedhojë opinionin e KLSH mbi raportimin financiar në sektorin publik gjatë këtyre viteve ka qenë i fokusuar vetëm në këto aspekte, duke rekomanduar në mënyrë të përsëritur nevojën që raportimi financiar në sektorin publik të kryet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS). Ekzekutimi i auditimit, përfshi garantimin e procedurave të testimit të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme mbi prezantimin e drejtë të raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar të shtetit, në çdo aspekt material, është një detyrë komplekse dhe kërkon një metodologji gjithëpërfshirëse dhe instruksione standarde të zbatueshme në nivel institucional.

Në Kongresin XXII të INCOSAI-t, në Abu Dhabi u perforcua *ideja se SAI-t, përmes auditimit të llogarive dhe operacioneve qeveritare, luajnë një rol të madh në promovimin e financave të shëndosha publike dhe llogaridhënies së përgjithshme në qeveritë e tyre. Është detyrë themelore e SAI-ve të shqyrtojnë nëse fondet publike shpenzohen me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret ekzistuese. Ndërsa SAI-t shqyrtojnë mobilizimin e burimeve (të hyrave) dhe menaxhimin e shpenzimeve (Shpenzimet), ato ndihmojnë në përmirësimin e proceseve kyçe të MFP-së. Në këtë mënyrë, SAI kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit, duke rishikuar auditimin e brendshëm dhe duke i bërë risqet të dukshme, duke botuar gjetjet dhe rekomandimet e tyre në faqet zyrtare të internetit (media, etj.)*<sup>13</sup>.

Në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014 – 2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Shtylla 4: Raportim qeveritar transparent, Kontabiliteti, Qeveria e Republikës së Shqipërisë është angazhuar që kontabiliteti dhe raportimi financiar në sektorin publik të kryen në përputhje me Standardet Europiane të Kontabilitetit Publik<sup>14</sup> (SEKP). Ky zhvillim e bën të domosdoshme që KLSH, të garantojë kapacitete institucionale të përshtatshme për të kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtarë të auditimit (SNA) mbi pasqyrat financiare të sektorit publik të përgatitura në përputhje IPSAS.

Për më tepër, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor përfshin, ndër të tjera, dhe pasqyrat financiare vjetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kërkesat e Ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kërkojnë që KLSH duke filluar nga viti 2018 të angazhohet në kryerjen e auditimeve financiare në përputhje me SNA mbi veprimtarinë financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore. Për realizimin e kësaj sfide, KLSH planifikon që do të shtojë kapacitetet veta të burimeve njerëzore ose do të kontrakttojë ekspertë të jashtëm të auditimit, në mënyrë që të përmbushë misionin e tij auditues edhe në përgjigje të dimensionit të ri të përcaktuar nga Ligji nr. 68/2017.

<sup>13</sup> Deklarata Kongresit XXII INCOSAI-t, Abu Dhabi Dhjetor 2016, “40 – Vjet Deklarata e Limës(1977 – 2017)” Seria Botime KLSH- 16 2017/83

<sup>14</sup> Komisioni European ka vendosur të përgatisë SEKP bazuar në IPSAS, të cilat mund të bëhen të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të BE-së duke filluar nga viti 2021.

Në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, qeveria synon përdorimin gjithnjë e më të gjerë të sistemit SIQF në raportimin financiar të njësive publike. Integrimi i përditshëm i të dhënave të kontabilitetit nëpërmjet Ndërfaqes/Lidhjes midis sistemit të SIFQ –it dhe sistemit tatimor digjital është një nga objektivat e qeverisë, sikundër dhe dhënia e aksesit të drejtpërdrejtë për institucionet e qeverisjes së përgjithshme në SIFQ me qëllim ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe kryerjen e raportimin financiar. Përdormi gjithnjë e më i gjerë i sistemeve IT në fushën e raportimit financiar në sektorin publik, kërkon që KLSH të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet në auditimin e këtyre sistemeve në funksion të efektivitetit të auditiveve financiare.

Në strategjinë 2018-2022, bazuar mbi zhvillimet e parashtruara më lart, në lidhje me auditimet financiare KLSH ka si objektiva:

Përgatitjen e metodologjisë standarde dhe të detajuar të auditimit financiar që të jetë sa më lehtësisht e zbatueshme nga audituesit.

Përgatitjen e formateve standarde të letrave të punës apo instruksioneve të detajuara në lidhje kryerjen e procedurave të detyrueshme të testimit dhe dokumentimin e punës audituese në përputhje me metodologjinë standarde të auditimit financiar dhe SNA.

Përgatitjen dhe rishikimin vjetor të instruksioneve standarde dhe procedurave të detajuara të auditimit financiar të cilat duhet të kryen nga çdo grup që auditon njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe vendore, të cilat shërbejnë për dhënien e opinionit nga KLSH mbi paraqitjen e drejtë, në çdo aspekt material, të raporteve financiare të konsoliduara të shtetit që paraqiten për miratim në Kuvend.

Hartimin e planit vjetor të auditimeve të KLSH që garanton, ndër të tjera, mbulimin e përshtatshëm, në çdo aspekt material, për dhënien e opinionit mbi raportet financiare të konsoliduara të shtetit që paraqiten për miratim në Kuvend. Në këtë plan të përfshihen dhe auditimet mbi sistemet IT që janë relevante për raportimin financiar të konsoliduar të shtetit.

Alokimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiarë për të rritur në vijimësi numrin dhe mbulimin nga auditimet financiare të kryera nga KLSH. Përveç planit vjetor për auditimet financiare, do të hartohet dhe plani afatmesëm për këto auditime me qëllim përmbushja në kohë e përgjegjësive ligjore të KLSH, në harmoni me zhvillimet e raportimit financiar në sektorin publik që drejtohen nga Qeveria e Shqipërisë.

Shtimin e burimeve njerëzore përgjegjëse për auditimet financiare për tju përgjigjur përgjegjësive të shtuara të KLSH si rrjedhojë e zhvillimeve në raportimin financiar në sektorin publik që drejtohen nga Qeveria e Shqipërisë.

Çertifikimin e audituesve të KLSH si Ekspertë Kontabël të Regjistruar dhe pjesëmarrjen e tyre në seksionet e edukimit të vazhdueshëm të organizuara nga IEKA, organizimin dhe pjesëmarrjen e audituesve në trajnime të vazhdueshme mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si dhe zhvillimin e moduleve të brendshme të trajnimit mbi SNA-të dhe metodologjinë standarde të auditimit financiar të KLSH.



---

#### 1.4. Fokusi në rritje drejt Auditimit të Performancës

KLSH është në linjë me konkluzionet dhe rekomandimet e rezolutave dhe kongreseve të INTOSAI-t “*për një qasje gjithëpërfshirëse drejt auditimeve të performancës dhe inkurajim për auditime të përbashkëta dhe për një shkëmbim më intensiv të njohurive mes SAI-ve*”.<sup>15</sup>

Auditimi i Performancës është konceptuar në strategjinë e kaluar si një nga shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, sipas eksperiencave botërore. Performanca është rritur shëndetshëm gjatë 5-vjeçarit të kaluar, me rrënjë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin e ri 154/2014, trung të ushqyer nga puna e kolegëve auditues, bashkëpunëtorëve vendas dhe të huaj dhe degë të shtrira në të gjithë sektorët që ushtrojnë aktivitet ekonomiko-social publik.

Në strategjinë 2018-2022, puna audituese në departamentit të performancës duhet të:

Fokusohet në çështje *makro-ekonomike*, krahas atyre *mikro-ekonomike*;

Vijojë të fokusohet në *auditime procesi* më shumë sesa *auditime institucioni*;

Riklasifikojë fushat audituese duke marrë në konsideratë edhe kritere të tjera, si: prioritetet qeverisëse, peshën sektoriale në buxhet, *e-government*, etj.

Klasifikojë dhe monetarizojë gjetjet, konkluzionet e rekomandimet sipas 3E-ve dhe jo thjesht në: *organizative e ligjore*, sikurse është tradita e KLSH-së në auditimet e ligjshmërisë dhe ato financiare;

Ruajë dhe promovojë profilizimin dhe specializimin e audituesve, duke krijuar një bërthamë apo lokomotivë profesionale që të menaxhojë ndryshimin dhe rrisë peshën e raporteve të performancës brenda e jashtë institucionit.

Shtojë filtrat garantues të cilësisë brenda Departamentit, duke rritur komunikimin mes kolegëve dhe ngritur grupe që vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Gjenerojë një numër më të madh auditimesh performace, me një rritje mesatare vjetore prej 4 auditime në vit. Kjo rritje duhet “financuar” ose duke shtuar nr. e audituesve të dept. të performancës (rekrutime të reja, qarkullim nga dept. të tjera tek performanca) ose duke krijuar një *drejtori të përgjithshme të performancës* që të ketë në përbërje dy apo tre dept. të cilat të kryejnë auditime “të pastra” performace dhe “të përziera” ku të dominojë elementi i performancës. Aktualisht në KLSH kryen mjaft auditime ligjshmërie ku në fakt trajtohen gjerësisht elementë të performancës.

Në mënyrë specifike fusha e auditimit të performancës përballet me risqe mjaft domethënëse si: ndryshimi i filozofisë dhe vizionit të hierarkisë drejtuese për rolin që duhet të mbartë auditimi i performancës brenda e jashtë institucionit, pasivitet i audituesve për të aplikuar metoda auditimi që klasifikojnë dhe monetarizojnë punën audituese sipas 3 apo më shumë E-ve, fokusimi në mikro-çështje audituese, duke gjeneruar auditime të segmentuara dhe me impakt pjesor e të tjera.

Objektivat për auditimin e performancës shkojnë përtej nxitjes së ndryshimit, duke synuar në rritjen e impaktit që këto auditime duhet të sjellin në interes të palëve të përfshira. Për këtë qëllim gjatë periudhës së ardhshme strategjike Departamenti i Auditimit të Performancës synon të:

Përcjellë në Kuvend çdo raport auditimi performace, duke kërkuar edhe të dëgjohet në seanca të posaçme për çështje kritike.

Shtojë peshën e vet të raportimit në dy raportet që KLSH përcjell çdo vit si dokumente integrale në Kuvend (Raporti për Zbatimin e Buxhetit Faktik dhe Raporti për Performancën Institucionale).

---

<sup>15</sup> Kongresi i XXII i INTOSAI-t në Abu d'Habi, “40-VJET Deklarata e Limës 1977-2017”, Seria Botime KLSH-16/2017/83

Rrisë pjesëmarrjen aktive në konferenca, *ëorkshop*-e e takime jashtë vendit, duke prezantuar dhe promovuar punën audituese;

Organizojë mbi baza periodike takime me gazetarët, akademinë dhe shoqërinë civile për të rritur impaktin dhe marrë *feedback*.

Ruajë dhe rrisë prezencën në median e shkruar, duke synuar kalimin edhe në median vizive.

Shtojë numrin e ndjekësve në kanalet sociale, duke targetuar moshën e re, për të ndërgjegjësuar brezin e ri për problemet e vendit dhe joshur ata drejt pjesëmarrjes në zgjidhjen e problemeve.

Nxisë dhe mbështesë botimet institucionale lidhur me performancën.

Auditimi i Performancës në KLSH, në momentin e hartimit të Strategjisë 2018-2022, ndodhet në një moment vendimtar. Të rritet duke u bërë promotor i zhvillimit institucional dhe konsoliduar në një auditim analitik, këshillues, bashkëpunues e vlerështues, apo të mbetet “krahu liberal” i një KLSH-je që perceptohet si penalizuese, e ngurtë, fanatike e ligjit dhe letrës dhe jo performancës e realitetit. Vizioni i hierarkisë drejtuese, Kryetarit, Drejtorit të Departamentit është për të parën dhe në këtë aspekt janë vendosur objektivat SMART për të ardhmen 5-vjeçare të Departamentit të cilat synojnë që numri i auditimeve të performancës të shkojë në 30-35% të punës audituese institucionale.

---

## 1.5. Thellimi në Auditimin e Teknologjisë së Informacionit

Konsolidimi i eksperiencave pozitive të përfituara gjatë viteve të kaluara përbën thelbin e zhvillimeve në përdorimin e TI-së në proceset audituese. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të auditimit të sistemeve TI, që përdoren për raportim financiar në sektorin publik dhe në proceset audituese në përgjithësi. Sfidat që lidhen me auditimin e TI-së, dhe prezantimi gjithnjë e më shumë i projekteve të qeverisjes elektronike (e-qeverisjes) shtron nevojën për zhvillimet të mëtejshme, shtrirje dhe thellim të këtij lloji auditimi, së cilës KLSH i përgjigjet duke e vendosur kryerjen dhe zhvillimin e auditimeve të TI si një ndër objektivat e saj strategjike edhe për periudhat e ardhshme.

Përhapja e shpejtë e teknologjisë kompjuterike dhe përdorimi i “Big Data” në auditim, kërkojnë investime në mjete vizualizuese e analizuese, auditues të TI të aftë, të mirëtrajnuar dhe që zotërojnë dijet e duhura për të dhënë siguri nëse kontrollet dhe proceset e përshtatshme janë vendosur dhe funksionojnë efektivisht për të menaxhuar riskun dhe vulnerabilitetin e sistemeve TI.

Objektivi i KLSH, për periudhat e ardhme, konsideron kalimin në një fazë të mëtejshme që synon konsolidimin e përdorimit të elementeve të Auditimeve TI-së në auditimet e përputhshmërisë, financiar dhe të performancës, përfshinë këto aspekte:

Zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të auditimit të sistemeve TI për dhënien e sigurisë të arsyeshme për çdo lloj auditimi: financiar, të performancës të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbi te dhënat që ruajnë këto sisteme.

Zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve audituese me teknikat CAAT, IDEA, COBIT dhe njohuri të teknologjisë së informacionit,

Pajisjen e audituesve IT të KLSH me çertifikata të njohura ndërkombëtarisht mbi auditimin IT, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme sipas angazhimeve financiare.

Ngritja e Drejtorisë së Auditimit të TI-së (e krijuar në Dhjetor të vitit 2014) në nivel Departamenti i Auditimit të TI-së do të synojë të krijojë kushtet e nevojshme për kryerjen e këtij

Iloj auditimi dhe ti hapë rrugën zhvillimeve të mëtejshme punës audituese të KLSH. Elemente të auditimit të TI-së do të vazhdojnë të shtrihen në Departamentet e Auditimit duke vazhduar praktikën e ngritur nga projekti i binjakëzimit për ngritjen e një linje të parë mbështetëse me njohuri TI-së në çdo departament dhe mbështetjes së saj nga trupa TI-së.

Në vitin 2018, KLSH përfundon procedurat për instalimin dhe implementimin e Programit për “Menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve” e cila synon që me anë të teknologjisë bashkëkohore moderne të automatizojë proceset e punës audituese të KLSH, duke përmirësuar dhe njëkohësisht lehtësuar menaxhimin e të gjithë llojeve të auditimit. Gjithashtu, do të përmirësohet sistemi i kontrollit të brendshëm të institucionit. Për vitet në vazhdim mbetet prioritet implementimi i Programit (ngritur mbi platformën REF Zonë) në mjediset e reja të KLSH, dhe zhvillimi i tij në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zhvillimet institucionale.

Në planin më afatgjatë strategjik KLSH do të bazohet në rekomandimet e Kongresit të X-të të EUROSAT-t të cilat konsistojnë në: shkëmbimin, shpërndarjen dhe ndjekjen e praktikave të mira të auditimit të TI-së; identifikimin e të gjitha pengesave që zvogëlojnë mundësinë e kryerjes së auditimeve të TI-së; përfshirjen e auditimit të TI-së në Strategjinë e SAT-t; krijimin dhe mbajtjen të përditësuar të informacionit në fushën e TI-së të të gjithë të audituarve dhe të të gjitha projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike (e-Government); dhe, sigurimin e programeve të trajnimit në stafin e auditimit të TI-së.<sup>16</sup>

---

## 1.6 Konsolidimi i Auditimit të Përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesat e ISSAI-ve

Eksperiencia e deritanishme e KLSH-së ka treguar se auditimet e përputhshmërisë janë lloji më i përhapur i auditimeve të kryera. Vlerësimet e institucioneve Ndërkombëtare kanë shprehur pozitivitet për sa i përket aftësive të audituesve në kryerjen e këtij lloj auditimi si dhe rezultateve të tyre. Megjithatë, KLSH njehevojën që ndërsa do të punohet në drejtim të rritjes së numrit të auditimeve financiare dhe të performancës, nuk mund të mbetet mënjane cilësia dhe konteksti i auditimeve të përputhshmërisë.

Në këtë drejtim KLSH synon të arrijë nivelin më të lartë të pajtueshmërisë me kërkesat ISSAI 400 të detajuara më pas në ISSAI e nivelit 4, ISSAI 4000. Realizimi i këtij objektivi kërkon:

Finalizimin e procesit të rishikimit të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë mbi bazën e rezultateve të vlerësimeve të auditimeve pilot të përputhshmërisë.

Hartimi i udhëzuesit të posaçëm për qasjen në përzgjedhjen e subjekteve për t’u audituar të bazuar në një vlerësim sistematik dhe të dokumentuar të riskut dhe materialitetit si dhe që të sigurojë që të gjitha subjektet brenda mandatit të KLSH të auditohen gjatë një periudhe të arsyeshme kohore.

Përfshirja në modulet e trajnimit të stafit kuadrin e rishikuar të manulave dhe të procedurave të lidhur me auditimin e përputhshmërisë.

KLSH bazuar ne Ligjin nr 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-se” ka kompetencën e kryerjes së Auditimit te Rregullshmërisë, i cili në vetvete nga pikëpamja e tipologjise është auditim i përzier ose miks pasi gjatë ushtrimit të këtij lloj auditimi, auditimi i përputhshmërisë (ISSAI 4100) kryhet së bashku me auditimin e pasqyrave financiare (ISSAI 300 dhe udherrefyesit e INTOSAI-t 1000-2999).

Zhvillimi i këtij auditimi në periudhat në vijim kërkon kryerjen e auditimit në përputhje me nivelin 4-të Udhërrëfyesve të INTOSAI-t dhe specifikisht me kërkesat e ISSAI 4000 i cili

---

<sup>16</sup>Kongresi X-të të EUROSAT-t, Turqi, 2017, [http://www.klsh.org.al/web/deklarata\\_e\\_kongresit\\_x\\_eurosai\\_1\\_3237.pdf](http://www.klsh.org.al/web/deklarata_e_kongresit_x_eurosai_1_3237.pdf)

përcakton kryerjen e auditimit të përputhshmërisë së bashku me auditimin e pasqyrave financiare, por jo vetëm, ky lloj auditimi përfshin dhe elemente të auditimit të etikës dhe integritetit në përputhje me Udhërrëfyesit e auditimit të etikës në sektorin publik. Ky aspekt është lançar së fundmi nga EUROSAI.

Kryerja e auditimeve të rregullshmërisë në këndvështrimin e perspektivave zhvillimit dhe zgjerimit të portofolit të llojeve të auditimit në KLSH, paraqet një sërë prioritetesh e avantazhesh, si dhe përfitime për palët e interesit, përfshi dhe subjektet e audituara, pasi do të rezultojë me dhënjën e një opinioni në një dimension gjithë përfshirësh referuar auditimeve në drejtimeve të mëposhtme:

verifikimin e përgjegjësisë financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe dhënjën e opinionit për pasqyrat financiare;

auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe të funksionimit të auditimit të brendshëm;

auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar.

Në këtë kontekst sfidat e zhvillimit dhe të përsosjes së këtyre auditimeve janë të gershetuara me ato të përputhshmërisë si dhe me auditimet financiare.

---

## 1.7 Cilësia si prioritet i KLSH - Përmirësimi i cilësisë dhe Përfitimi nga Auditimet e KLSH

Një nga mënyrat që KLSH do të vijojë të aplikojë për të shtuar vlerë dhe të prodhojë përfitime në forcimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisjes në tërësi dhe të njërive të sektorit publik është duke ofruar vlerë dhe cilësi në vetë auditimet e kryera prej tij. Në Deklaratën e Abu d’Habi <sup>17</sup> në Dhjetor 2016 u theksua se “*Është detyrë e SAI-t të kryejë auditime të cilësisë së lartë dhe t’u japin qytetarëve raporte që mbështesin transparencën , përgjegjshmërinë e mirë dhe besimin në qeverisje.*”

Duke njohur dhe duke qenë të ndërgjegjshëm që cilësia është thelbësore për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit në shërbim të Kuvendit dhe të qytetarëve shqiptarë, KLSH do të:

Adoptojë Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë i cili përfshin të dy anët: kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. **Kontrolli i cilësisë** do të konsolidohet nëpërmjet zbatimit të përpiktë të Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH. Kjo procedurë mbështetet edhe nga **Sigurimi i Cilësisë**, i cili kryhet nga individët të pavarur (d.m.th. nuk kanë marrë pjesë në procesin e auditimit që po rishikojnë).

Miratojë Manualin për Sigurimin e Cilësisë<sup>18</sup> sipas ISSAI 40, i cili do të jetë udhërrëfyesi kryesor për efektivitetin e menaxhimit total të cilësisë në auditim.

Konsolidojë dhe forcojë strukturat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë duke e konsideruar këtë si pjesë e procesit të vazhdueshëm të përmirësimit po ashtu dhe rritjes së impaktit të rezultateve të punës së saj.

Shtrijë sigurimin e **cilësisë së auditimeve me burime të jashtme** duke adoptuar si pjesë të procedurave për sigurimin e cilësisë edhe procedura që lejojnë vlerësimin e rregullt dhe

---

<sup>17</sup> Kongresi XXII INCOSAI- Abu d’Habi, Dhjetor 2016, “40 – Vjet Deklarata e Limës(1977 – 2017)”, Seria Botime KLSH- 16 2017/83

<sup>18</sup> Produkt i Projektit IPA 2013 “Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm”

monitorimin me përgjegjësi të përcaktuara qartë për punën e ekspertë të jashtëm. Kjo do të përfshijë dhe implementimin e Standarteve për Kontrollin e Brendshëm në Qeverinë Federale (*Green Book*) të GAO-s në procedurat e kontrollit të cilësisë.

---

## 1.8 Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, rritja e nivelit të rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara.

Efekti real i aktivitetit auditues së KLSH-së matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet publike të audituara, institucionet ligj-zbatuese dhe politikë-bërësit. Për këtë arsye, në vitet e fundit, institucioni suprem i auditimit publik ka treguar angazhim dhe këmbëngulje në identifikimin dhe aplikimin e instrumentave të duhur për të rritur ndjeshmërinë e të gjithë palëve të interesit ndaj produkteve të KLSH-së në drejtim të pranimin dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë aktivitetit auditues.

Instrumentet kryesor që përdorë KLSH-ja për realizimin e këtij objekti janë:

Ndërtimi dhe implementimi i sistemit të procedurave dhe infrastrukturën e duhur brenda institucionit, për të siguruar gjurmimin sistematik dhe periodik të zbatimit të rekomandimeve<sup>19</sup>.

Krijimi i një baze të dhënash për identifikimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit si dhe përdorimin e mjeteve të TI-së në funksion të këtij qëllimi.

Përdorimi i marrëveshjet e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe aktorë të tjerë për zhvillimin e instrumenteve të duhur me përfitim të përbashkët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit publik (përfshirë auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm).

Forcimi i bashkëpunimit me Kuvendin dhe veçanërisht me Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, dhe

Sinergjizimi me faktorë të tjerë për t'i kërkuar qeverisë<sup>20</sup> të vendosë dhe implementojë urdhëra e udhëzime për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Përdorimin e instrumenteve si një garanci shtesë që do të japë siguri të mëtjshme se KLSH duhet të ketë në dispozicion burimet njerëzore, materiale dhe monetare të nevojshme dhe të arsyeshme për kryerjen e plotë të auditimeve. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë “*de facto*” autoriteti që duhet të vendosi mbi disponibilitetin e burimeve të institucionit të auditimit të jashtëm publik.

---

## 1.9. RITJA E IMPAKTIT TË RAPORTIMEVE NËPËRMJET RITJES SË PËRDORUESVE TË PRODUKTEVE TË KLSH-SË

KLSH është e angazhuar që në mënyrë të vazhdueshme të performojë sa më mirë, të jetë bashkëveprues dhe gjithëpërfshirës për të maksimizuar vlerën që ofron, nëpërmjet zhvillimit të

---

<sup>19</sup> *Infrastruktura ligjore përbëhet nga kërkesat e Ligjit 154/2014 të mbështetura nga procedurat e përcaktuara në Rregulloret e Brendshme dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Udhëzim nr. 1 datë 04.11.2016 “Për procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

<sup>20</sup> *Që prej vitit 2013, nuk ka asnjë Urdhër të KM për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.*

ekspertizës, për t'iu përgjigjur problemeve dhe sfidave që dalin dhe për të qenë e aftë të demonstrojë autoritetin e duhur për të gjeneruar impakt pozitiv për çështjet që auditohen.

Në kuptimin tradicional, marrëdhënia e KLSH me grupet e interesit është konceptuar si një rrjedhje informacioni e njëanshme: kundrejt Kuvendit, publiku, subjektet e audituara dhe grupe të tjera të interesit. Media, organizatat e shoqërisë civile dhe në veçanti qytetarët i përdorin raportet e KLSH si burim informimi të sigurt rreth performancës qeverisëse, e cila nga ana tjetër mund të përdoret si kërkesë për ndryshim në sisteme e procedura. Kjo kërkon që KLSH t'i paraprijë sfidave dhe problemeve të sektorit publik në Shqipëri në të ardhmen me qëllim që t'i integrojë ato në punën audituese duke u siguruar se rekomandimet e KLSH janë kuptuar drejt, dhe implementimi i tyre të sjellë ndryshime pozitive.

KLSH synon të rrisë influencën dhe impaktin e auditimeve të saj duke zgjeruar bazën e përdoruesve të produkteve të saj, gjetjeve, opinionëve dhe rekomandimeve të auditimeve, për t'i shërbyer qoftë përdoruesve direkt ashtu dhe indirekt, duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari i thjeshtë. Ky objektiv strategjik realizohet nëpërmjet:

Përmirësimin të qasjeve dhe cilësinë e raporteve si produkt i punës audituese, duke e konsideruar raportimin jo më si fazë përmblylëse të auditimit, por si një pjesë të një procesi të gjërë për arritjen e ndryshimeve përfituese.

Rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të sistemit të raportimit në formë dhe përmbajtje në mënyrë që rezultatet e auditimit të jenë të lexueshme, më të përshtatshme dhe më të aksesueshme. Këto rishikime dhe përmirësime do të synojnë që auditimet të influencojnë në mënyrën se si administrohen dhe menaxhohen vendimet e qeverisë dhe mënyrën se si shërbimet publike parashikohen dhe u ofrohen qytetarëve.

Mundësimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit si mjet i depozitimeve të ankesave dhe ku publikohen vendimet e plota të auditimeve.

Rritjes së profesionalizimit në trajtimin e problemeve me të cilat ballafaqohen subjektet që auditohen me qëllim të promovojë besimin e publikut.

Ndryshimin në qasje të informacionit, duke theksuar rëndësinë e një marrëdhënie më të sofistikuar që siguron fluksin e dyanshëm të informacionit, që përfshin si konsultimin ashtu dhe bashkëpunimin.

Modernizimin e kanaleve të komunikimit për të forcuar mesazhet kyç në qasje të çdo pale të interesit duke aplikuar metoda dhe rrugë inovative, duke theksuar rëndësinë e komunikimit efektiv midis KLSH dhe publikut në ruajtje dhe rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë brenda Qeverisë.

Identifikimi i perceptimit të veprimtarisë së KLSH-së nga qytetari dhe palët e tjera të interesit nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile të specializuar për të realizuar këto lloj matjesh, do të përbëjë instrumentin bazë të përmirësimin të vazhdueshëm të instrumenteve që do të rrisin impaktin dhe përdoruesit e produkteve të KLSH-së.

---

#### 1.10. ROLI I KLSH-SË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Synimet e KLSH-së për dimensionin e integritetit dhe të parandalimit të korrupsionit shkojnë përtej institucionit, duke e shtrirë atë në të gjithë organet shtetërore. Objektivin kryesor në Strategjinë e 2018-2022 do të jetë miratimi nga Kuvendi i *ligjit për "Përgjegjësinë materiale"* i cili konsiderohet si një mjet mjaft i rëndësishëm për të luftuar "në rrënjë" korrupsionin i cili injektohet "... ne arteriet e funksionimit të shtetit nga "Kultura e pandëshkueshmërisë" dhe mungesa e vënies përpara përgjegjësisë të nëpunësve të lartë të Shtetit, abuzues me interesin publik"



Arritja e këtij objektivi kërkon që KLSH të :

Bashkëpunojë me faktorët kyç vendimmarrës në mënyrë të vazhdueshme, pasi kjo iniciativë do të sillte impakt pozitiv të dyanshëm, jo vetëm si një hap cilësor në luftën kundër korrupsionit, por do të shërbejë si një instrument mjaft konstruktiv për optimizimin e rezultateve të veprimtarisë audituese të KLSH-së, duke sjellë vlerë të shtuar në vetë institucionet që auditohen.

Evidentojë mekanizmat konkretë të bashkëpunimit, mbi baza vjetore, rezultatet e të cilit duhet të bëhen publike dhe ti dërgohen Kuvendit në formën e një Raporti të Posaçëm apo si pjesë e Raporteve Vjetore të Veprimtarisë së çdo institucioni pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, që KLSH ka nënshkruar me institucionet e tjera shtetërore, veçanërisht me organet e zbatimit të ligjit.

Krijojë grupe të përbashkëta institucionale me detyra konkrete për monitorimin e evidentimin e problematikave dhe rasteve të lidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e fondeve publike nëpërmjet bashkëpunimit, si dhe përgatitjen e Raportit të përbashkët për informimin e ndërsjellët për titullarët e institucioneve.

Kryejë Auditimet e Integritetit të nëpunësve publikë, bazuar në eksperiencat më të mirat të ndërkombëtare si ajo e SAI-t Hollandezë dhe Hungareze, të cilat kanë zhvilluar vlerësimin e integritetit të të gjitha institucioneve publike të vendeve respektive, duke synuar nxitjen e parandalimit të korrupsionit.

Aplikimi i metodologjisë së INTOSAINIT si instrument i strukturuar për realizimin e Auditimit të integritetit dhe Etikës së institucioneve të tjera publike. Gjetjet e këtij aktiviteti auditimi do të përdoren për të axhornuar “Hartën e riskut në nivel kombëtar” të vendit dhe do të përdoret si sinjalizues “Flamujt e kuq/Red Flegs”, për planifikimet e aktivitetit auditues.

Përfshirja në programet e auditimit, kryerjen e auditimit të integritetit dhe etikës gjatë veprimtarisë audituese duke kontribuar kështu në forcimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik<sup>21</sup>.

Duke marrë në konsideratë mprehtësinë e këtij problemi të evidentuar qartazi edhe nga aktivitet audituese, KLSH do të insistojë ndërtimin e një njësie apo komiteti ndërinstitucional apo kombëtar për të krijuar frontin e përbashkët të luftës ndaj korrupsionit duke marrë masat për parandalimin e tij.

---

## **QËLLIMI 2. OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE, AFTËSIVE AUDITUESE, PROCEDURAVE TË PUNËS, LOGJISTIKËS DHE FUNKSIONEVE TË TJERA MBËSHTETËSE**

INCOSAI XXII përcaktoi profesionalizimin *si proces i vazhdueshëm i fitimit me autoritet të cilësisë dhe statusit të ekspertit dhe të etikës, duke demonstruar një nivel të lartë të kompetencës ose aftësisë*, dhe si tillë ai është adresuar me rëndësi të veçantë nga KLSH dhe së bashku me moton e këtij Kongresi “*Të bashkuar në vendosmëri dhe ambicje*” përbën qëllimin strategjik për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe rritjen e aftësive audituese të stafit. KLSH e konsideron *..cilësinë dhe profesionalizimin si fjalët kyçe të punës së cdo anëtari të stafit...*<sup>22</sup>

---

<sup>21</sup>INTOSAI GOV 9100 – 9600

<sup>22</sup> Projekt-Ide paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë nga Dr. Bujar Leskaj, 14 Dhjetor 2011. “KLSH Analiza Vjetore 2011”, Seria: Botime KLSH: 01/2012

## 2.1. KORNIZA MATJES PERFORMANCËS - SI MJET VLERËSIMI DHE FAKTOR ZHVILLIMI TË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka adoptuar zbatimin e Kornizës së Matjes së Performancës së SAI - t<sup>23,24</sup>, në mënyrë vullnetare si një mjet i rëndësishëm për të zhvilluar kapacitetet. Nëpërmjet aplikimit të kësaj kornize KLSH synon të masë performancën kundrejt standardeve të INTOSAI-t po ashtu dhe praktikave të mira. KLSH është e angazhuar të zhvillohet si një institucion që udhëheq nëpërmjet shembullit. Rishikimi sistematik i performancës do t'i mundësojë KLSH-së të ndjekë progresin në aspektet kryesore dhe të sigurojë informacion të rëndësishëm mbi të cilin mund të bazohen vendimet menaxheriale dhe organizative. KMP mundëson vlerësimin e performancës në mënyrë tërësore: korniza mbulon si punën audituese, qeverisjen e brendshme dhe etikën, marrëdhëniet me aktorët e jashtëm, si dhe pavarësinë dhe kornizën ligjore. Kjo njih faktin që SAI-t janë institucione komplekse, dhe se performancat në aspekte të ndryshme janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Vlerësimi i nevojave nëpërmjet KMP do të jetë baza mbi të cilën KLSH do të parashikojë zhvillimet strategjike, duke u mbështetur në informacione dhe të dhëna konkrete, të cilat identifikojnë aspektet dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të siguruar përputhshmëri të plotë me standardet e pranuar, menaxhimin e performancës, përcaktimin e mundësive për t'u përmirësuar dhe monitoruar punën e KLSH, si dhe për të rritur transparencën e llogaridhënien.

KLSH synon të përdorë KMP për:

Ndërtimi i matricës së pikëzuar sipas gjashtë fushave të parashikuara në këtë metodologji. Ky proces do të jetë i përshkallëzuar për tre vitet e para të zbatimit të strategjisë.

Ngritjen e grupet e punës, që do të aplikojnë KMP për ekzaminimin dhe vlerësimin e fushave sipas treguesve dhe dimensioneve respektive. Rezultatet sipas pikëzimeve do të raportohen duke ndjekur udhëzuesin e KMP për hartimin e raportit dhe publikimin e tij

Përgatitjen e raporteve të performancës vjetore institucionale të mbështetur në evidencën dhe kuptimin e drejtë të ndërlidhjes midis fushave të performancës, duke treguar vlerat dhe përfitimet, se si KLSH kontribuon për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit në vend.

Përcaktimin e masave afat-shkurtër dhe afat-gjatë, që të adresojnë problematikat e identifikuar dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e aktivitetit të KLSH-së me qëllim që të sigurohet përmirësimi i vazhdueshëm i performancës institucionale.

---

## 2.2. ZBATIMI I STANDARDEVE PROFESIONALE NËPËRMJET ZHVILLIMIT TË METODOLOGJIVE DHE STANDARDEVE TË APLIKUESHME NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKAT MË TË MIRA TË

Motoja e Kongresit të X-te të EUROSAT-t në Maj 2017, cilësoi “Zbatimin e ISSAI-ve: Sfidat dhe zgjidhje për zhvillim të mëtejshëm”. Zbatimi i standardeve profesionale konsiderohet prej KLSH-së si një prej sfidave të vazhdueshme me të cilat përballen të gjithë SAI-t në nivel global.

Implementimi i Standardeve ISSAI është një proces dinamik dhe një prej sfidave të zhvillimit institucional të KLSH-së. Në përmbushje të këtij objekti strategjik, institucioni është

---

<sup>23</sup> Kongresi XXII INCOSAI-t miratoi Kornizën e Matjes së Performancës së SAI-t (PMF) nëpërmjet së cilës KLSH ashtu si SAI-et anëtare të INTOSAI-t u angazhua të krijojë një kuadër global të vlerësimit të performancës së SAI-ve, që mund të tregojë se si SAI-të në të gjithë globin po kryejnë punën dhe misionin e tyre, si dhe se si kjo performancë po përmirësohet.

<sup>24</sup> “Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve”, Seria: Botime KLSH – 07/2017/74, Tiranë 2017

angazhuar rishqyrtime dhe riformulime të metodologjive të auditimit të KLSH-së, proceseve dhe procedurave, për të siguruar përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me standardet profesionale dhe vlerat.

Në një linjë me objektivat strategjike të INTOSAI<sup>25</sup>-t dhe EUROSAI<sup>26</sup>-t, **vizioni i KLSH-së** për implementimin të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit konsideron se njohja, implementimi i ISSAI-ve përbëjnë një objektivi parësor në funksion të rritjes dhe forcimit të profesionalizmit performancës dhe kredibilitetit institucional.

Në përmbushje të këtij vizioni, KLSH do të vijojë me implementimin e ISSAI-ve<sup>27</sup>, proces i nisur me angazhimin e KLSH në vitin 2013 me nënshkrimin e Marrëveshjes me IDI nën Programin 3i-ve “ Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve”, duke:

Avancuar deri në implementimin e plotë të kërkesave të niveleve 3<sup>28</sup> dhe 4 të ISSAI-ve në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë audituese.

Analizuar kuadrin rregullator ekzistues referuar mundësisë së hartimit dhe miratimit të Standardeve të Auditimit të Jashtëm Publik për Kontrollin e Lartë të Shtetit, të cilat do të mundësojnë që standardet dhe normat ndërkombëtare të profesionit të kthehen në parime dhe rregulla të zbatueshme në kontekstin shqiptar të zhvillimit. Baza e këtij procesi do të jenë rekomandimet e adresuara nga Kongresi i X i EUROSAI-t sipas të cilit: *“Duke marrë parasysh se mandatet e auditimit janë të ndryshme, EUROSAI konkludon se ISSAI-të ofrojnë një kornizë të përbashkët veçanërisht për auditimin financiar dhe rekomandon që ISSAI-të të harmonizohen me kornizat ligjore kombëtare të SAI-ve”*<sup>29</sup>

Implementuar Standardet e Auditimit të Qeverisë (Yellow Book) dhe Standardet për Kontrollin e Brendshëm në Qeverinë Federale (Green Book) të Zyrës së Auditimit të Qeverisë të SHBA, GAO-s.

Përmirësuar Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Auditimit Financiar, mbështetur në rekomandimet e vlerësimeve nga SIGMA, duke reflektuar kërkesat e Standardeve të nivelit 3, ISSAI 200 dhe 400 dhe duke i pasuruar me udhërrëfyesit specifik të fushës së auditimit sipas dhe kërkesave të ISSAI-ve të nivelit 4<sup>30</sup>.

Hartuar manuale specifike të detajuara për fusha dhe drejtime të caktuara për auditimin të Performancës, Financiar, të Përputhshmërisë e Rregullshmërisë, si dhe auditimin të TI-së bazuar në Udhërrëfyesit e Përgjithshëm të Auditimit të INTOSAI-t dhe për mirëqeverisjen INTOSAI GOV.

---

<sup>25</sup> INTOSAI-t për periudhën 2017-2022 përcakton si objektivi parësor zhvillimin e Standardeve Profesionale dhe konkretisht: *“INTOSAI do të vijojë të promovojë Institucione të pavarura, të zhvilluara, multidisiplinore dhe do të inkurajojë mirëqeverisjen nëpërmjet: Mbështetjes për gjenerimin dhe ruajtjen e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe kontribuimin për zhvillimin dhe miratimin e standardeve profesionale efektive*

<sup>26</sup> Kongresin e X i EUROSAI-t, Maj 2017 theksohet që: *“EUROSAI rekomandon përmirësimin e zbatimit të ISSAI-ve dhe nëse është e mundur reflektimin e ISSAI-ve në progresin e SAI-ve”*

<sup>27</sup> Marrëveshja me Iniciativën e Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI), INTOSAI Development Initiative, Mars 2013

<sup>28</sup> Niveli 3, përmban parimet fundamentale të auditimit dhe japin një platformë konceptuale për Auditimin Financiar, Auditimin e Performancës dhe Auditimin e Përputhshmërisë duke siguruar dhe konsistencën me kuadrin e ISSAI-ve.

<sup>29</sup> Konkluzione dhe rekomandime. Kongresi i X i EUROSAI-t 23-25 Maj 2017. Stamboll, Turqi

<sup>30</sup> Niveli 4 i standardeve përfaqëson nivelin kryesor në referim të praktikës auditimit bazuar në ISSAI dhe përmban kërkesat për udhëzimin e auditimit në praktikë në trajtën e udhëzimeve operacionale që mund të përdoren gjatë veprimtarisë audituese. ISSAI (1000-4999) përfshin setin e kërkesave të rekomanduara që duhet të përmbushin audituesit gjatë kryerjes së auditimit financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë

---

## 2.3 NXITJA DHE PROMOVIMI I VLERAVE TË LARTA PROFESIONALE TË AUDITUESVE

Kapitali human, audituesit mbeten aseti më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm për KLSH-në duke konsideruar që sukcesi në përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të saj varet në mënyrë të ndjeshme nga të krijuarit të një trupe auditimi kompetente dhe të mirëtrajnuar. Në këtë kontekst, politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore, të KLSH përfshijnë nëntë elementët e përmendur në zbatimin e udhërrëfyesit brenda Kontrollit të Cilësisë për SAI-t, ISSAI 40, duke i dhënë rëndësinë e duhur cilësisë dhe angazhimit të KLSH ndaj parimeve etike<sup>31</sup>. Nëpërmjet këtyre elementeve theksohet domosdoshmëria e kulturës së edukimit të vazhdueshëm nga audituesit.

Nëpërmjet politikës së edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional KLSH synon të:

Sigurojë që stafi auditues të zotërojë aftësitë dhe dijet e kërkuara për të realizuar me profesionalizëm çdo aspekt që mund të përballen gjatë punës audituese.

Aplikojë sistemin e trajnimit të vazhdueshëm të hartuar në përputhje me nevojat individuale të audituesit në mënyrë që të reflektojë nga njëra anë nevojat specifike të individit për njohuri specifike gjatë gjithë jetës,

Hartojë dhe ndjekë planin e zhvillimit profesional të gjithsecilit sipas kërkesave të sintetizuara në objektivat specifike të Programit Vjetor të Trajnimit

Realizojë mesatarisht i 25 ditë trajnimi në vit për çdo punonjës së institucionit suprem të auditimit, duke matur njëkohësisht impaktin e këtij sistemi në përfomancën e punës audituese.

Vendosë një sistemi motivimi që do të ketë për qëllim krijimin e një lidhjeje të ngushtë ndërmjet audituesve dhe institucionit nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit intensiv të parashikuara dhe që zhvillohen në KLSH. Për këtë qëllim implementimi i dokumentit të Politikave të Burimeve Njerëzore të KLSH-së përbën instrumentin kryesor për promovimin e vlerave profesionale të audituesve nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm, pasi bazohet në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të vlerave.

---

## 2.4. FORCIMI I SISTEMIT TË STRUKTURUAR TË EDUKIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE PUBLIKË DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM

Mbështetur në ISSAI 200 – ‘Standardet e Përgjithshme të Auditimit’ sipas të cilit “... SAI duhet të adoptojnë për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tyre për t’i aftësuar ata të kryejnë detyrën e tyre efektivisht dhe për të përcaktuar bazat për avancimin profesional të audituesve dhe te stafit tjetër...”, KLSH e konsideron trajnimin dhe zhvillimin profesional të audituesve si një standard auditimi.

Audituesit e jashtëm të sektorit publik duhet të jenë të aftë t’i përgjigjen ndryshimeve të ambientit ekonomik, social, teknologjik dhe të ballafaqohen me standardet në rritje, jo vetëm të aktivitetit auditues, por edhe të përballen me presione politike e publike apo sfida të tjera që lidhen me vetë vulnerabilitetin e profesionit të auditimit. Për të mbështetur dhe ndihmuar audituesit të përballen në mënyrë efektive me këto sfida, KLSH synon të :

---

<sup>31</sup> Këto politika dhe procedura lidhur me burimet njerëzore përfshijnë: - rekrutimin (dhe kualifikimin e stafit të rekrutuar), - vlerësimin e performancës, - zhvillimin profesional, - promovimin, - kompensimin, dhe - vlerësimin e nevojave të personelit, Dokumenti Politikave të Burimeve Njerëzore, KLSH, Dhjetor 2017

Realizojë rregullime ligjore për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme dhe burimet e duhura për të përmbushur objektivin në mënyrë cilësore dhe me qëndrueshmëri afat-gjatë.

Vendosë një Sistem të Çertifikimit të Audituesve të Jashtëm Publik, duke përmirësuar kuadrin ligjor mbështetës për këtë qëllim. Sistemi i çertifikimit ndërtohet duke marrë në konsideratë eksperiencën e GAO-s, si dhe eksperiencën e tjera të ngjashme të vendeve të BE, siç është eksperiencën e SAI-t Kroat.

Zhvillojë një Program për Çertifikimin e Audituesve në formën e moduleve të strukturuar dhe duke aplikuar kurse praktike të dedikuara brenda KLSH-së si dhe në bashkëpunim me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit apo me organizma të tjerë të profesionit.

Zhvillimin e kapaciteteve të strukturës përkatëse teknike për rishikimin periodik të metodologjisë dhe formateve standarde të auditimit që garantojnë përputhshmërinë në çdo kohë me SNA, si dhe për ofrimin e asistencës së specializuar teknike për audituesit në lidhje me interpretimin në raste komplekse të SNA dhe IPSAS. Konsulenca nga kjo njësi mund të kërkohej si e detyrueshme për rastet e dhënies së një opinioni të modifikuar me qëllim garantimin që ky opinion është i mbështetur në evidenca të përshtatshme auditimi.

Krijimi “Qendrës së Ekselencës” si qendër e formalizuar e trajnimit për auditimin e jashtëm publik, për kultivimin dhe shpërndarjen e dijeve dhe njohurive të profesionit të auditimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objekti i referohet ndryshimit të idesë kryesore në të cilën bazohet sistemi i trajnimit në KLSH: nga metoda e “mbushjes së boshllëqeve”, pasojë e mungesës së politikave të zhvillimit profesional dhe sistemit të trajnimeve në periudhën 2005-2011, në ofrimin e mundësive punonjësve më të mirë për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese të cilësisë së lartë.

---

## 2.5. IMPLEMENTIMI DHE MONITORIMI I VAZHDUESHËM I DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË BURIMEVE NJERËZORE TË KLSH-SË

Monitorimi i vazhdueshëm, vlerësimi i implementimit të Dokumentit të Politikave të Burimeve Njerëzore do të jetë një nga mjetet me të cilat KLSH do të masë efektivitetin e këtyre politikave, dhe do të mbajë të përditësuar sistemin e menaxhimit të këtyre burimeve për të siguruar që KLSH shpërndarjen dhe përdorimin me më efektivitet të këtyre burimeve.

Implementimi i plotë i kësaj politike kërkon përmbushjen e aktiviteteve të reflektuara në Planin e Veprimit dhe burimet e infrastrukturës e cila parashikon masat që do të ndërmerren në periudhën afat-shkurtër dhe në atë afat-gjatë.

Objekti për Zhvillimin Strategjik 2018-2022 kërkon që burimet njerëzore të:

- Rekrutohen, kultivohen, monitorohen dhe promovohen vetëm në përputhje me dijet e tyre dhe kontributin profesional në punën audituese;

- Trajnohen dhe testohen sipas një kalendari dhe kurrikule të planifikuara në terma vjetorë, të specializuar në përputhje me eksperiencën dhe fushën audituese, të harmonizuara me trajnimet e tjera brenda e jashtë vendit;

- Motivohen financiarisht sipas një plani të mbështetur në performancë;

- Ndryshojnë qasjen e tyre nga reaktive në proaktive.

- Shfrytëzojnë ekspertizën vendase dhe të huaj në dobi të auditimit dhe jo anasjelltas.

---

## 2.6. INTEGRITETI SI VLERË THEMELORE

Në fokus të politikave të ndjekura nga lidhshëm-i i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka qenë ndërtimi i një sistemi efektiv të integritetit, si dhe funksionimi efektiv dhe i vazhdueshëm i tij, duke e konsideruar atë si pjesë integrale e menaxhimit të përditshëm të institucionit të KLSH-së dhe jo një politikë të përkohshme. Objektivi i kësaj qasjeje është impakti në krijimin e një sistemi dhe ambienti jo korruptiv dhe implementimin e një kulture etike dhe me integritet. Në kuadër të përmbushjes së objektivit për modernizimin e institucionit gjatë viteve të fundit KLSH, ka ndërmarrë hapa konkrete dhe një sërë iniciativash për instalimin në institucionin e KLSH-së të një infrastrukture efektive etike dhe me integritet

Aplikimi që prej vitit 2013 i INTOSAINT, si mjet për vetëvlerësimin e integritetit është baza mbi të cilën KLSH ka ngritur një sistem efektiv të kontrollit të integritetit dhe një infrastrukture etike efektive dhe kontribuon duke udhëhequr sipas shembullit në promovimin e integritetit në sektorin publik dhe rrjedhimisht për një qeverisje të mirë.

KLSH nëpërmjet Sektorit të Etikës dhe Integritetit synon zbatimin dhe forcimin e politikave të ruajtjes së vlerave të Kodit të Etikës për Audituesit dhe kultivimin e integritetit në institucion dhe për çdo individ në veçanti do të vazhdojë angazhimin e plotë dhe pa kompromis të KLSH për të krijuar një ambient ku vlerat etike dhe integriteti të jenë tipare thelbësore në formimin e përgjithshëm të audituesit shtetëror. Kjo do të realizohet nëpërmjet:

Implementimit të Kodit të Etikës si një deklaratë e plotë e vlerave dhe parimeve të cilat e udhëheqin punën e përditshme të audituesve për të siguruar që sjellja e tyre është e paqortueshme në të gjitha kohët dhe në të gjitha rrethanat në përputhje të plotë me kërkesat e ISSAI 30

Aplikimit të metodologjisë së INTOSAINT si instrument vetëvlerësimi që nxit dhe promovon integritetin dhe sjelljen etike si pjesë të rëndësishme të përgjegjshmërisë individuale dhe institucionale.

Forcimit të strukturës përgjegjëse për kontrollin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të Kodit të Etikës dhe vlerësimin e integritetit të stafit të KLSH

Instrumenti i vetëvlerësimit të integritetit në KLSH është zhvilluar dhe do të vazhdojë të konsolidohet në zbatim të udhëzimeve dhe parimeve të INTOSAINT si metodologji, si dhe në përputhje me kërkesat e standardit ISSAI 41 “*Instrumenti për analizën e boshllëqeve*”.

---

## 2.7. FORCIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

KLSH synon të mbajë dhe të përditësojë kuadrin e ngritur ligjor e rregullator në shërbim të qeverisjes së brendshme, duke implementuar politika dhe procedura kontrolli efektive për të mbajtur një ambient kontrolli të shëndetshëm.

Adoptimi dhe implementimi i Standarteve të e Kontrollit të Brendshëm të Qeverisë (*The Green Book*) do të mundësojë aplikimin e kriterëve për hartimin, implemetimin dhe funksionimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm mbi bazën e parimeve të pesë komponentëve të kontrollit: mjedisin e kontrollit, vlerësimin e riskut, veprimtaritë kontrolluese, monitorimin dhe informimin e komunikimin, sipas përcaktimeve të modelit COSO<sup>32</sup>.

Në mbështetje të sistemit të kontrollit të brendshëm të krijuar dhe në përgjigje të nivelit të maturisë institucionale të arritur, KLSH do të vendosë fokusin në :

---

<sup>32</sup> Komiteti i Sponsorizimit të Organizatave të Komisionit të Profesionëve, Kontrolli i Brendshëm –Kuader i Integruar (New York: American Institute of Certified Public Accountants, 2013).



Nxitjen e zbatimit dhe funksionimit efektiv të kuadrit të kontrollit duke theksuar njëkohësisht rolin parandalues po aq sa dhe zbulues e korrigjues të veprimtarive të kontrollit.

Kryerjen e analizave sistematike për të identifikuar fuqitë dhe dobësitë si dhe shqyrtuar alternativat e zhvillimit.

Rishikimet funksionale me qëllim që të identifikohen në kohë nëse ka mangësi apo dhe dublikime të funksioneve, nëse njësitë organizative (Departamente, Drejtori e Sektorë) kanë detyra të ndara dhe të përshkruara qartë, nëse procedurat dhe linjat e raportimit sigurojnë që problemet të identifikohen shpejt dhe veprimet korrigjuese janë ndërmarrë në kohë.

Forcimin e strukturave dhe kapaciteteve që sigurojnë kryerjen dhe funksionimin e kontrolleve

Marrjen e veprimeve dhe masave korrigjuese në kohë dhe ndjekjen e zbatimit të tyre për të korrigjuar impaktin negativ të rasteve të shkeljeve, në mënyrë të veçantë të çështjeve lidhur me etikën dhe integritetin.

Monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolleve dhe veprimtarive në këndvështrimin e përmirësimit të vazhdueshëm.

Adoptimin i politikës së sinjalizuesve/“whistle-blower” si dhe përdorimin e instrumenteve efektivë për të siguruar transparencën, përgjegjshmërinë e veprimtarisë së tij në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

Thelbin e objektivit për forcimin e kontrollit të brendshëm do ta përbëjë ruajtja e vlerave, integritetit dhe etikës në kryerjen e detyrave audituese nga çdo individ të çdo niveli ekzekutiv dhe drejtues në KLSH.

KLSH synon të ruajë një sistem efektiv të menaxhimit të riskut duke e integruar atë në planet dhe veprimtaritë e vjetore të punës. Menaxhimi i riskut nuk konsiderohet si një program i shkëputur, por duhet të bëhet përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese. Për këtë qëllim KLSH do të :

Përditësojë Strategjinë e Menaxhimit të Riskut nëpërmjet së cilës të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative.

Administrojë Regjistrin e Riskut, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun risqet e identifikuar, në mënyrë se si ato kanë ndryshuar gjatë periudhës, po ashtu dhe të pasqyrohen elementet e rinj të riskut të perceptuar.

Konsolidojë strukturën e Auditimit të Brendshëm e krijuar në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të IIA-së dhe Ligjit 114/2015 “Për organizimin e auditimit të Brendshëm në sektorin publik në Shqipëri” duke siguruar në vijimësi që personeli i ngarkuar me këtë përgjegjësi të ketë mandatin e duhur, aftësitë, përvojën dhe burimet e nevojshme për realizimin e këtij funksioni.

### **QËLLIMI 3. FORCIMI I KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT**

KLSH do të vijojë angazhimin për të kontribuar në zhvillimet e profesionit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitete bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar dhe rajonal dhe në mënyrë të veçantë në pjesëmarrjen e tij në grupet e punës dhe “task forcës” të krijuar për çështje specifike.

---

### 3.1 Konsolidimi i marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin

Mbështetur në praktikat më të mira dhe konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga dokumente vlerësuese të SIGMA- s dhe Bankës Botërore/ PEFA-s, KLSH do të theksojë dhe më tej kërkesën për organizimin e dëgjësave publike dhe në mënyrë të veçantë të Komisioneve përkatëse Parlamentare me njësitë e audituara, me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe rritjen e impaktit të raporteve të KLSH. Ndërgjegjësimi i anëtarëve të Kuvendit për vlerën që i sjell shtetit dhe shoqërisë një auditim efektiv publik dhe rolin e ndërsjellë të legjislativit në rritjen e impaktit dhe shtimin e vlerës së auditimeve të KLSH duhet të qëndrojë në themel të përpjekjeve të KLSH për të siguruar një ambient të jashtëm mbështetës dhe të dobishëm.

Aktivitet dhe objektivat e synuara të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë konsistojnë në:

Paraqitja dhe diskutimi i platformave potenciale të politikave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis KLSH-së dhe Parlamentit

- a. Vendosja e strukturës në nivel komisioni apo nën komisioni që do të angazhohet me aktivitetin auditues të KLSH-së
- b. Komisionet sektoriale të trajtojnë në mënyrë specifike raportet e auditimeve të performancës
- c. Përcaktimi i një axhende të veçantë për paraqitjen e raporteve të KLSH-së
- d. Përcaktimi i personave respektivë të kontaktit si dhe autoritetin e tyre.

Dakortësimi mbi Memorandumin e Bashkëpunimit me Parlamentin mbi procedurat e bashkëpunimit dhe finalizimi i tij.

- a. Organizimi i takimeve të rregullta me Parlamentin, të cilat do të përgatiten nga takimet në nivelet teknike.
- b. Përfshirja e komisioneve të tjera parlamentare
- c. Sigurimi që të gjitha raportet e KLSH-së zotërohen nga të gjithë anëtarët respektivë të parlamentit
- d. Organizimi i trajnimeve/informime mbi misionin dhe aktivitetin e KLSH-së për anëtarët e rinj të parlamentit
- e. Organizimi i trajnimeve/informime mbi misionin dhe aktivitetin e KLSH-së për këshilltarët e komisioneve
- f. Organizimi i konferencave të përbashkëta, tryeza të rumbullakëta apo ëorkshope
- g. Informimi i përgjithshëm nëpërmjet doracakëve dhe buletineve përmbledhës katër mujorë

Ngritja e procedurave standarde për një bashkëpunim efektiv por pa cenuar pavarësinë e KLSH-së

- a. Dakortësimi mbi një procedure konsultimi para se të kërkohet një auditim specifik nga Parlamenti
- b. Ndjekja e diskutimeve dhe e shqetësimeve relevante të anëtarëve të parlamentit për identifikimin e auditimeve potenciale në të ardhmen.

Llogaridhënia/përgjegjshmëria dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve duke përfshirë:

- a. Raportimi i mënyrë të veçantë mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nga entitet publike;
- b. Organizimi nga komisionet parlamentare përkatëse seanca dëgjimore me entet publike të audituara
- c. Komisionet parlamentare të kërkojnë në mënyrë specifike planin e veprimit nga qeveria apo institucione të veçanta për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

- d. Në rastet serioze të mos zbatimit të rekomandimeve, Parlamenti të vendosë sanksione (politike, financiare apo disiplinore).

---

### 3.2. Roli i KLSH në Axhendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm

Kongresi XXII i INTOSAI-t në Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe vendosi angazhimin për rritjen e kontributit të INTOSAI-t dhe SAI-ve në Axhendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke përfshirë mirëqeverisjen në mënyrë që të forcojë luftën kundër korrupsionit.

Duke konsideruar rolin kritik që SAI-t kanë për të garantuar hartimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm si dhe integritetin, besueshmërinë, dhe krahasueshmërinë e statistikave kombëtare që i paraqiten OKB-së nga vendet e ndryshme për të vlerësuar progresin kundrejt Axhendës 2030, Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022 është e ndërtuar e orjentuar në përmbushje të këtyre angazhimeve që i përkasin sferës ndërkombëtare. Kjo Strategji Zhvillimi vendos si një nga dimensionet strategjike të zhvillimit, dhënien e kontributit për ndjekjen dhe vlerësimin e përmbushjes së objektivave të Axhendës 2030, nëpërmjet:

Angazhimi në krahasim të anëtarëve të tjerë të INTOSAI-t për të punuar së bashku me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të përshtatshme për kryerjen e auditimeve të performancës në lidhje me OZHQ-të.

Vlerësimin e aftësisë së qeverisjes qendrore për të raportuar në lidhje me progresin dhe përmbushjen e OZHQ-ve, si dhe auditimin e veprimtarisë së saj dhe besueshmërinë e dhënave që gjenerohen.

Kryerjen e auditimeve të performancës në lidhje me ekonomikitetin, efektshmërinë dhe eficientësinë e programeve kryesore qeveritare që kontribuojnë për OZHQ-të.

Vlerësimin dhe mbështetjen e zbatimit të Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Nr. 16 që lidhet me institucione transparente, eficientë dhe llogaridhënëse.

Të qenit shembull i transparencës dhe llogaridhënies gjatë veprimtarisë së tij.

INCOSAI XXII deklaroi se është thelbësore të sigurohet që referenca dhe konsiderimi i OZHQ-ve të inkorporohet në të gjitha fazat e procesit të auditimit, duke përfshirë: zgjedhjen e temave të auditimit; si dhe, duke marrë parasysh OZHQ-të si një prioritet horizontal në planet strategjike të SAI-ve.

Planifikimi i auditimeve përfundimisht duhet të rezultojë në një mbulim më të mirë të OZHQ-ve në raportet e auditimit<sup>33</sup>. Këto deklarata konsiderohen nga KLSH si objektiva të rëndësishëm për të arritur gjatë zbatimit të Strategjisë afatmesme të Zhvillimit .

---

### 3.3. Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë për Komunikim të KLSH-së

Politika e komunikimit është konsideruar jetike për rolin dhe përmbushjen e misionit të KLSH-së, po ashtu dhe dobishmëria e saj në funksion të maksimizimit të vlerës së produkteve, raporteve të auditimit si dhe zbatimit të rekomandimeve. Strategjia e zhvillimit 2018-2022 do të përmbushi kërkesat e Strategjisë së Komunikimit 2017-2019 dhe synon :

Perceptimin e drejtë të parimeve dhe funksioneve të KLSH nga publiku dhe qytetari, nga institucionet, organizatat joqeveritare dhe media.

---

<sup>33</sup>Deklarata e Kongresit të XXII, INCOSAI, Abu D'habi, Dhjetor 2016

Stimulimin e një debati publik rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH, debat i cili çon më pas në rritjen e sensibiliteteve të grupeve të ndryshme shoqërore, ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të institucionit përgjatë auditimeve të tij.

Realizimi i komunikimit të KLSH me grupe të ndryshme shoqërore, duke vendosur në qendër qytetarin, do të sjellë rritjen e kontrollit qytetar dhe shoqëror në përdorimin e Buxhetit të Shtetit.

Objektivat strategjikë të KLSH në komunikimin me publikun dhe palët e tjera të interesit janë përcaktuar në bazë të nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit dhe përfshijnë:

*Objektivi Nr. 1:* Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

*Objektivi Nr. 2:* Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

*Objektivi Nr. 3:* Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

*Objektivi Nr. 4:* Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rrumbullakëta.

*Objektivi Nr. 5:* Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.

*Objektivi Nr. 6:* Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.

Për këtë qëllim implementimi në të gjitha dimensionet e Strategjisë së Komunikimit 2017-2019, do të përbëjë instrumentin më efikas jo vetëm për të rritur impaktin e aktivitetit auditues së KLSH-së, por edhe për forcuar partneritetin me palët e interesit duke i bërë ata aleatët më besnik të tij për të rritur presionin ndaj qeverisë për zbatimin sa më të plotë të rekomandimeve të institucionit të auditimit të jashtëm publik.

---

### 3.4. Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet e tjera

*Moto e INTOSAI-t "Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë" (Experientia mutua Omnibus prodest)* përbën thelbin mbi të cilin është hartuar dhe zhvilluar Strategjia për Zhvillim e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Bashkëpunimi me partnerët qeveritarë, në angazhime të përbashkëta dhe pse rolet janë të ndryshme, konsiderohen nga KLSH si një mjet për rritjen e efektivitetit të punës, pasi veprimtaritë e ndjekura bashkërisht sigurojnë impakt më të madh të auditimeve të tij. KLSH vlerëson se koordinimi dhe bashkëveprimi me palët e interesit dhe subjektet e audituara e bëjnë më efektiv dhe më eficient vetë institucionin dhe për më tepër shërbimin e tij ndaj publikun dhe Kuvendin *“Angazhimi me qytetarët dhe aktorët e tjerë të jashtëm mund të forcojë kapacitetet dhe efektivitetin e SAI-ve në bërjen e qeverive të përgjegjshme”*<sup>34</sup>

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, vendos si shtyllën e 6 të saj rolin e KLSH në mbikëqyrjen efektive të financave publike, dhe implementimi i kësaj Strategjie mbështetet në mënyrë thelbësore nga bashkëpunimi efektiv midis KLSH dhe Sistemit të KBFP, e cila theksohet dhe më tepër në përcaktimet e Kapitullit 32 të *Acquis communautaire*.

Për këtë qëllim, objektivat strategjikë në fushën e bashkëpunimit reciprok që KLSH vendos për në vitet në vijim synojnë :

Të mbajnë dhe të forcojnë marrëdhënie profesionale efektive me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ministritë e linjës dhe institucione të tjera shtetërore nëpërmjet:

---

<sup>34</sup> SAI dhe Praktikë e angazhimit të palëve të interesit, Raport OECD, 2014

- a. Realizimit të plotë në vitet që vijojnë i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë që mbulon kooperimin e përbashkët në fushë e auditimit publik dhe inspektimit financiar.
- b. Mbështetjes për auditimin e brendshëm në sektorin publik, po ashtu dhe të mbështetet në punën e audituesve të brendshëm duke rritur efektivitetin e mbikëqyrjes së financave publike në përgjithësi dhe me përfitime dyanëshe në një perspektivë më të gjerë të krijimit të një kulture të përbashkët auditimi në sektorin publik.
- c. Bashkëpunimit në fushën e standardeve të kontabilitetit publik që do të mundësojë një kuptim më të mirë të vendosjes dhe zhvillimit të këtij sistemi për të dy palët, audituesit dhe ekzekutivin.
- d. Bashkëveprimit me strukturat qeveritare dhe organizatat profesionale në fushën e kontabilitetit publik, për të garantuar kapacitete institucionale të përshtatshme dhe të afta për të kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtarë të auditimit (SNA) mbi pasqyrat financiare të sektorit publik të përgatitura në përputhje IPSAS<sup>35</sup>.
- e. Shtirjes dhe forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese dhe me përfitim të ndërsjellët me ministri të tjera dhe institucione shtetërore për rritjen e efektivitetit të proceseve audituese si dhe të zbatimit të rekomandimeve të tyre.
- f. Shkëmbimit të informacionit me njësitë e sektorit publik, për rritjen e efektivitetit të auditimit, cilësisë së të dhënave dhe shmangies së mbivendosjes së veprimtarive

Të bashkëpunojë me Institucionin e Prokurorisë dhe Strukturën e Inspektimit Financiar si një nga prekuizitat për të qenë i suksesshëm në luftën kundër rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit në sektorin publik dhe për të vënë para përgjegjësisë ligjore nëpunësit dhe drejtuesit që papërgjegjshmërinë në përdorimin e fondeve publike.

Si pjesë e Strategjisë Antikorrupsion të bashkëpunojë me strukturat përkatëse për realizimin e veprimtarive dhe arritjen e objektivave të kësaj Strategjie duke përdorur qasje shumë palëshe të agjencive shtetërore me mbështetjen e shoqërisë civile.

Bërjen efektive të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit Pastrimit të Parave, Autoritetit të Konkurrencës do të mundësojnë që informacioni i dyanshëm të rrjedhë midis palëve duke siguruar rritjen e efektivitetit të secilës prej tyre.

Përdorimi i instrumenteve të përshtatshëm në vendosjen e ambientit bashkëpunues me të gjitha palët dhe ruajtja e cenimit të pavarësisë së auditimit janë parashkushtet për krijimin e marrëdhënieve korrekte dhe profesionale bashkëveprimi.

---

<sup>35</sup> Qëllimi Strategjik 1, Objektivi 1.1: Auditimi Financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit

## VI. FAKTORËT KRITIK TË SUKSESIT – SI NXITËS TË NDRYSHIMIT

Në formulimin e Strategjisë së Zhvillimit, KLSH i ka kushtuar vëmendjen e duhur dhe rëndësi të madhe përcaktimit të faktorëve kritikë të suksesit për të rritur sigurinë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjikë. Këta faktorë në vlerësimin dhe gjykimin tonë do të bëjnë diferencën në suksesin apo dështimin e Strategjisë për Zhvillim 2018 - 2022.

Përcaktimi i faktorëve kritikë të suksesit rrit efektivitetin tonë në formulimin, përcaktimin dhe vendosjen e objektivave dhe produkteve të cilat i përgjigjen në fund të fundit kërkesave dhe nevojave të publikut, Parlamenti dhe çdo pale tjetër të interesit në nivel kombëtar.

Nëpërmjet Analizës SWOT janë adresuar pikat e dobëta dhe të forta të institucionit, po ashtu dhe mundësitë apo kërcënimet duke i identifikuar ato mbështetur në analizën e nevojave aktuale të përdoruesve të produkteve tona, por njëkohësisht dhe kërkesave që palët e interesit do të kërkojnë për t'u ofruar në periudhën 5 vjeçare.

KLSH është gjithnjë vigjilent ndaj faktorëve të ambientit të jashtëm, situatën dhe performancën ekonomike e social-politike të vendit, përfshirë ligjvënësin i cili i jep formë dhe përcakton ambientin në të cilin funksionon sektori publik. Implementimi i reformave qeverisëse pritet të ketë gjithnjë impakt si në politikat e reja po ashtu dhe në krijimin, ndryshimin apo dhe ridizenjimin e strukturave qeverisëse të niveleve të ndryshme në sektorin publik si ofrues të shërbimeve publike.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të tilla ndryshime bëhen pjesë e faktorëve që kanë dhe do të kenë impakt në ushtrimin e veprimtarisë së KLSH. Kjo kërkon që KLSH të formojë dhe të mbajë të përditësuar një këndvështrim bashkëkohor të sektorit publik në Shqipëri dhe në mënyrë të përgjegjshme të hartojë e zbatojë programimin e punës audituese mbi bazë të qasjes së integruar të planifikimit të tillë që të japë siguri objektive mbi performancën e sektorit publik dhe për më tepër mbi qëndrueshmërinë e një sektori publik në zhvillim e progres.

Mbajtja e marrëdhënieve efektive me Legjislativin, nëpërmjet një vlerësimi objektiv të roleve respektive, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë funksionale të secilës prej palëve dhe nxitur transparencën, me qëllim përmirësimin e qeverisjes, konsiderohet element kyç për arritjen e qëllimeve strategjikë të KLSH. Është i njohur tashmë roli i KLSH-së dhe se si mund të mbahet dhe forcohet besueshmëria e Parlamentit nëpërmjet një komunikimi të rezultateve të auditimit dhe ofrimit të cilësisë së lartë, si dhe bazuar në evidentimin e produkteve të auditimit nëpërmjet kanaleve të përshtatshme.

Për të ruajtur besueshmërinë e tij, KLSH duhet të mbajë të njëjtat standarde të performancës sikurse vlerëson dhe njësitë e sektorit publik. Kjo kërkon krijimin dhe mbajtjen e një sistemi qeverisës dhe menaxhues të brendshëm i cili do të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm institucional, dhe të gëzojë fleksibilitetin për të qenë i aftë të përballojë më sukses ndikimet e jashtme.

Eksperienca e gjashtëvjeçarit të fundit ka treguar se drejtimi dhe udhëheqja institucionale është një faktor përcaktues në implementimin e suksesshëm të qëllimeve dhe objektivave strategjikë të përfshirë në Strategjinë së Zhvillimit, 2018-2022.

*Përgjegjshmëria e lartë profesionale dhe përgjegjësia aktive, frymëzuese dhe gjithëpërfshirëse karakterizuese për drejtimin e KLSH përbën një bazë të efektive mbi të cilën institucioni do të hedhë hapa të sigurtë në rrugën e të qenit të suksesshëm për periudhën strategjike 2018 - 2022*

Implementimi i qëllimeve dhe objektivave të shpalosura në këtë Strategji Zhvillimi duhet të



analizohen ngushtësisht me menaxhimin në mënyrë dhe formë të përshtatshme të rreziqeve shoqërore me to. Përcaktimi i rreziqeve potenciale për t'u përballur gjatë përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave strategjikë është thelbësor në arritjen e sukseshme të tyre. Vendosja e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut, përfshirë identifikimin të rregullt dhe ndërmarrjes së aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e risqeve, është tashmë e adresuar në Strategjinë e Menaxhimit të Riskut dhe reflekton këndvështrimin e drejtimit të lartë të KLSH në trajtimin e këtij faktori kyç të suksesit.

### **Ndryshimet në Profesionin e Auditimit, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në zhvillim.**

KLSH është e angazhuar të nxisë mendimin e përparuar kur është fjala për inovacionin e auditimit. Që prej vitit 2012, KLSH ka iniciuar investime të rëndësishme në metodologjitë e zgjeruara, teknologjitë e reja dhe trajnime substanciale nëpërmjet marrëveshjevetë bashkëpunimit strategjik me Organizatat Ndërkombëtare të Auditimit, organizmat profesionale dhe institucionet homologe pjesë e network-ut të auditimit të jashtëm publik.

**Sistemet e Teknologjisë së Informacionit.** Teknologjia është elementi me nivelin më të lartë të ndryshimit dhe KLSH do të vazhdojë të intensifikoje përdorimin e teknologjisë për të mbështetur kërkesat e veprimtarisë audituese. Në përpjekjet e saj në arritjen e qëllimeve dhe objektivave KLSH do të kushtojë vëmendjen e duhur nevojave lidhur në fushën e teknologjisë. Kjo do të përfshijë vlerësimin dhe përditësimin e sistemeve ekzistuese dhe adoptimin e sistemeve të reja të tilla që ti përgjigjen proceseve të reja dhe të jenë të përshtatshme, të besueshme dhe të sigurta. Ky faktor duhet të konsiderohet ngushtësisht me burimet në dispozicion.

Pëfshirja e stafit në mënyrë të drejtëpërdrejtë përgjatë gjithë procesit të draftimit dhe implementimit të Strategjisë së Zhvillimit është faktori kyç i suksesit. Kështu të qenit pjesë në procesin identifikimit të pikave të forta dhe të dobësive; procesin e identifikimit të instrumenteve përmirësuese; sugjerimin e alternativave të zhvillimit, ka synuar që çdo individ të jetë realisht kontribues konkret në përgatitjen e këtij produkti.

Një qasje e tillë u mundëson stafit të KLSH të qenit veprues aktivë dhe në implementimin e Strategjisë, ç'ka përbën në vetvete një faktor tjetër për rritur sigurinë e arritjes së objektivave të vendosura në këtë Strategji.

Janë këto faktorë në të cilët besojmë se do të kenë një ndikim transformues në auditimin dhe, më gjerësisht, raportimin dhe ofrimin e produkteve të institucionit të KLSH. Mendësia dhe aftësitë inovative që po zhvillohen në KLSH, synojnë të përshtatin aftësinë dhe zotësinë e përpunimit analitik të të dhënave të auditimit. Këto janë pjesë e përpjekjeve në kuadër të ndërtimit të një sistemi zhvillimi dhe profesionalizmi që i jep prioritet angazhimit të KLSH për të rritur cilësinë e auditimit, për të rritur njohuritë mbi praktikatat më të mira dhe për të nxitur një kulturë të inovacionit midis njerëzve tanë. Kontrolli i Lartë i Shtetit mbetet gjithnjë përkrahës i ndryshimeve dhe zhvillimeve që rrjedhin nga ndryshimet globale dhe lokale në profesionin e auditimit dhe në mënyrë të veçante për auditimin të jashtëm publik.

Angazhimi i KLSH në organizatat ndërkombëtare INTOSAI, EUROSAI si dhe të qenit pjesë e një network-u shumë të gjerë të institucioneve ndërkombëtare të auditimit dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë i ka dhënë dhe vijon t'i mundësojë institucionit mundësinë për të bashkëpunuar dhe mësuar nga të tjerët. Forcimi dhe rritja e efektivitetit të këtyre marrëdhënieve do të mbështesin dhe ndihmojnë zhvillimin e metodologjive të cilat përforcojnë cilësinë e operacioneve dhe shërbimeve të auditimit.

Strategjia në tërësi konsiderohet si një plan apo proces i integruar i hartuar dhe i zhvilluar për të siguruar arritjen e objektivave kryesorë.

Për KLSH-në strategjia e re e zhvillimit për 5 vitet e ardhshme është konsideruar si instrumenti i përmirësimit të proceseve audituese dhe të rritjes profesionale të stafit, modernizimit të teknologjive inteligjente që përdoren në auditime dhe që mbështesin funksionimin e institucionit, ridizenjimin e aktivitetit të trupës audituese dhe të atij mbështetëse, për të realizuar misionin, vizionin dhe objektivat e përcaktuara në këtë dokument.

Ky dokument përshkruan qartësisht drejtimit e zhvillimit të KLSH-së, duke u fokusuar në mënyrë të detajuar mbi mundësitë dhe risqet e suksesit në përmbushjen e objektivave që janë në fokus për periudhën 2018-2022, siç janë auditimet e performancës, të teknologjisë së informacionit apo ato financiare.

Për një performancë sa më të mirë të KLSH-së, e cila konsiderohet si sistem apo tërësi procesesh, optimizimi i burimeve/kufizimeve dhe objektivave përbën metodologjinë e duhur për të funksionuar me efektivitet apo pothuajse perfekte.

Optimizimi i strategjisë së zhvillimit i mundëson institucionit suprem të auditimit publik të sjelli më shumë efekt nëpërmjet proceseve audituese, në përdorimin me efektivitet të fondeve publike për rritjen e mirëqenies së qytetarëve duke:

- marrë në konsideratë faktorë apo dimensione të shumtë – gjatë gjithë fazave të procesit si të planifikimit, realizimit dhe raportimit të misioneve audituese duhet konsideruar jo vetëm riskun por edhe kostot operacionale. Pjesë e këtij procesi është edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve.

- iu përgjigjur në mënyrë dinamike ndaj ambientit ekonomik dhe atij operacional-bashkëveprimi dhe bashkëpunimi me aktorët dhe faktorët kyç të ambientit ku KLSH realizon veprimtarinë është identifikuar si instrumenti që do të rrisë efektin e rekomandimeve dhe të produkteve në përmbushje të misionit kushtetues

- menaxhuar më mirë kufizimet – kufizimet e adresuara janë të lidhura jo vetëm me burimet financiare por edhe kufizimet e racionalitetit të kapitalit njerëzor.

- marrja e vendimeve më të mira për qytetarët dhe institucionin – nëpërmjet optimizimit të kufizimeve financiare dhe operacionale që ndikojnë në vendimmarrjen.

- menaxhimi më i mirë i palëve të interesit – nëpërmjet optimizimit identifikohen aktorët kryesorë dhe burimet e duhura që do të çojnë në rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve specifike që kanë impaktin më të madh në mirë përdorimin e fondeve publike

Optimizimi i strategjisë së zhvillimit mund të realizohet për periudhat afatshkurta nëpërmjet ndryshimeve minimale në proceset e auditimit dhe menaxhimit operacional, apo mund të integrohen në sistemin e menaxhimit strategjik duke përdorur zgjidhjet e optimizimeve dinamike në nivel individual të proceseve.

Pikërisht për të mundësuar këtë analizë Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së për 2018-2022 është shoqëruar me objektivat SMART (specifike, të matshme, të arritshme, realiste, dhe në kohë).

## VII. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SDP 2018 -2022

Vizioni ynë është të ndërtojmë një institucion suprem të auditimit të një niveli të krahasueshëm evropian e më tej botëror, një shembull i vërtetë i performancës së mirë dhe mbi të gjitha si mbrojtësi i interesit publik.

Strategjia e Zhvillimit mbart sfida që në përgjithësi janë trajtuar në këtë Strategji, por me të cilat ne jemi të ndërgjegjshëm se do të përballemi gjatë implementimit të saj.

Kontrolli i Lartë i Shtetit për pesë vitet e ardhshme 2018 -2022 do të menaxhohet mbi bazën e kësaj Strategjie Zhvillimi dhe qëllimeve të përcaktuara që lidhen me rezultatet që duhet të arrihen.

Strategjia e Zhvillimit do të monitorohet në vijimësi dhe rishikohet në mënyrë sistematike çdo vit. Kjo do të mundësojë që KLSH të ndjekë progresin, të marrë siguri se po ecën në drejtim të objektivave të vendosura në këtë Strategji dhe njëkohësisht ofron informacion të rëndësishëm për vendimmarrje efektive dhe në kohë.

Performanca e Kontrollit të Lartë të Shtetit do të matet nëpërmjet rishikimeve vjetore të progresit për çdo qëllim strategjik dhe objektivat përkatëse të përfshirë në këtë Plan Veprimi që shoqëron këtë Strategji.

Matja e Indikatorëve të Performancës dhe vlerësimi i nivelit aktual të tyre kundrejt parashikimit do të na shërbejnë për:

- Të siguruar informacion të përditësuar për progresin e Strategjisë në përgjithësi; (Indikatorë të situatës)

- Për të identifikuar në kohë vështirësitë apo ndonjë risk të mundshëm që çënon arritjen e objektivave (Indikatorë Paralajmërues)

- Vendimmarrje më të mirë dhe përgjigje në kohë ndaj sfidave (Indikatorë të Politikave)

- Krijuar dhe forcuar bashkëpunimin efektiv ndërmjet gjithë Departamenteve dhe strukturave të KLSH-së

- Për të mbajtur efektiv dhe real implementimin e Parimit të Transparencës dhe komunikimit të rezultateve të KLSH për publikun, Parlamentin dhe komunitetin e palëve të interesit.

Analiza e arritjeve vjetore të çdo objektiwi strategjik dhe monitorimi i progresit do të udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe Departamenti Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit në bashkëpunim të ngushtë me çdo Departament dhe strukturë drejtuese dhe operacionale të KLSH.

Gjetjet dhe propozimet e tyre përpilohen në “Raportin e Monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së” të çdo viti dhe bëhen të njohura për grupet e interesit, publikun dhe për gjithë stafin e KLSH në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Në mënyrë të veçantë do të punohet në drejtim të përcaktimit se cilat do të jenë veprimet dhe masat që do të ndërmerren për të siguruar përparimin e vazhdueshëm të çdo qëllimi strategjik në veçanti, veprime dhe hapa të ardhshëm, nëse ka, janë më së shumti të nevojshëm për përparimin e vazhdueshëm drejt çdo qëllimi.

Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit duhet të punojë si katalizator për çuarjen përpara të Strategjisë si për vetë KLSH-ën ashtu dhe çdo palë interesi, publikun dhe Parlamentin. Po kështu këto vlerësime do t'i shërbejnë dhe palëve apo organizatave ndërkombëtare të cilat kontribuojnë në zhvillimin e institucionit tonë.

Secili drejtues i objektivave dhe kontribuesit përkatës - duke përfshirë organizatat rajonale - do të shqyrtojnë rezultatet e arritura për secilin objektiv në bazë të standardeve të miratuara, siç janë performanca e matur kundrejt objektivave të përcaktuara dhe përfundimi i detyrave të rëndësishme apo produkteve.

Pasi të jetë vlerësuar çdo qëllim, secili drejtues i objektivave do të shqyrtojë rezultatet në të gjitha qëllimet brenda objektivit strategjik përkatës dhe do të përcaktojë prioritetet për veprimet e ndryshme dhe hapat e mëtejshëm që janë identifikuar. Duke pasur parasysh burimet e fundme, kjo qasje synon të sigurojë që vëmendja të përqendrohet në veprimet që nevojiten për të vazhduar progresin, për të përmirësuar performancën, ose për të menaxhuar rreziqet.

Njëkohësisht, implementimi i suksesshëm i saj do të jetë një faktor kyç në kontributin tonë për mirëmenaxhimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë në qeverisjen e financave publike.

## **ANEKSI 1: METODOLOGJIA**

Metodologjia për zhvillimin e përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018 -2022, është bazuar në praktikën kryesore të zhvillimit Planit Strategjik të KLSH 2013 -2017, Udhëzuesit për Planifikimin Strategjik të SAI-ve nga IDI dhe sipas procedurave për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik të përcaktuar në Rregulloret e Brendshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Plani Strategjik i INTOSAI-t dhe EUROSAI-t kanë qenë dhe mbeten udhërrëfyesit më të rëndësishëm në përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave strategjike të institucionit.

Në linjë me parimet e komunikimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me ekspertë dhe grupet e interesit, Kryetari i KLSH ngriti Grupin e Punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, me pjesëmarrje të përfaqësuesve më të lartë të drejtimit të KLSH , si dhe ekspertë të jashtëm të fushës akademike dhe profesionale lidhur me auditmin. Strategjia e Zhvillimit u bazua në vlerësimin e nevojave dhe në vlerësimin e kuadrit institucional që mbulojnë aspekte kryesore të organizimit dhe identifikimin e mangësive ose fushave që kanë nevojë për përmirësime të performancës. Ajo përfshin një kuadër rezultatesh, duke respektuar hierarkinë logjike të qëllimeve Misioni – Vizioni – qëllimet - objektivat; ose inputet – aktivitetet –outputet – rezultati – ndikimi.

Objektivat e përcaktuara shoqërohen me një numër treguesish të matshëm dhe konkretë, të nevojshëm këto për matjen dhe vlerësimin e arritjeve gjatë monitorimit të progresit. Për këtë qëllim është përgatitur dhe Plani i Veprimit i cili identifikon dhe i jep prioritet projekteve që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet dhe objektivat e planit strategjik, dhe që identifikon rreziqet për arritjen e tij.

Strategjia e Zhvillimit është hartuar duke vënë theksin në reflektimin e pritshmërive të grupeve të interesit të KLSH, dhe është plotësuar me identifikimin e rreziqeve që mbartin objektivat e vendosura.

Neni 9 i ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, vendos hapin e parë të detyrimit ligjor të KLSH për të kryer veprimtarinë e tij në mënyrë të planifikuar. Ai përcakton se KLSH vendos në mënyrë të pavarur dhe në çdo kohë për planin e veprimtarisë së tij, gjatë së cilit mund të marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga njësitë e tjera të qeverisjes së përgjithshme.

Kontrolli i Lartë i Shtetit planifikon veprimtarinë e tij mbi bazën e Planit Strategjik disa vjecar (zakonisht 5 vjecar, 1+4 vite) dhe e përditëson atë cdo vit. Planifikimi strategjik është baza nëpërmjet së cilës KLSH përcakton prioritetet për zhvillim të periudhës strategjike në drejtim të përmbushjes së qëllimeve dhe arritjes së objektivave strategjike të institucionit.

Strategjia e Zhvillimit është konsideruar dhe aplikuar si mjet i menaxhimit për të drejtuar në mënyrë efektive dhe me vizion të qartë kryerjen e veprimtarisë së KLSH në përputhje me parimet etike dhe profesionalizëm. Planifikimi mbështetet mbi një analizë të detajuar, duke përcaktuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe duke analizuar mangësitë dhe mundësitë e KLSH për periudhën strategjike që planifikohet.

Në Strategjinë e Zhvillimit parashikohet planifikimi dhe shpërndarja efektive e burimeve materiale dhe njerëzore që do të shërbejnë në arritjen e objektivave të përcaktuara.